



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:085464

Datë: 09.07.2024

Numri i dokumentit: 05915553

**PKR.nr.90/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda**, në përbërje prej Kryetarit të Trupit Gjykes – Gjykatësit **Drilon Haraçia** dhe gjykatësve profesional **Driton Sadiku dhe Ilir Rashkaj** - anëtar, dhe me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve B.H., nga fsh..... Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari .SH.H., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për shkak veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit N.H., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.83/2020, të datës 14.09.2020, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datë 25.07.2023 26.09.2023, 17.10.2023, 14.12.2023, 06.02.2024, 18.03.2024 19.03.2024, 16.05.2024, 06.06.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiarj - Hyseni, të dëmtuarit D.SH., si dhe të akuzuarit B. H. dhe mbrojtëses së tij av.Mone Sylja nga Gjakova, sipas autorizimit, të akuzuarit Sh.H., dhe mbrojtëses së tij av.Edona Sina nga Gjakova, sipas autorizimit dhe të akuzuarit N.H., dhe mbrojtësi i tij av.Egzon Doli, avokat nga Gjakova, sipas autorizimit me datën 11.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi me dt.09.07.2024, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të akuzuarve:**

**B.H.**, nga i ati K., e ëma ., e gjinisë J., i lindur me datën ....., në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ....

**Sh.H.**, nga i ati ., e ëma ., e gjinisë Prushi, i lindur me datën .... në Gjakovë, tani me vendbanim në fshatin D., Komuna e Gjakovës, po ashtu me vendbanim në . ., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, automekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ....

**N.H.**, nga i at.,, e ëma ., e gjinisë .... i lindur me datën ....., në fshatin ....., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon, i martuar baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ....

...

## **A).PJESA DËNUESE**

### **JANË FAJTOR**

#### **Të akuzuarit B.H., dhe Sh.H.,**

**I.Sepse** me datën 15.07.2020 rreth orës 09:00/h në Gjakovë, saktësisht në parkingun e Restorantit “...” në Gjakovë, të pandehurit në bashkëveprim me njëri tjetrin i sulmojnë personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe atë të dëmtuarin D.SH., zyrtar policor në Gjakovë, në atë mënyrë, i dëmtuari deri sa ishte duke implementuar planin operativ ditor heqja e parkimeve të pa rregullta në brendësi të qytetit së bashku me kolegun e tij A.T., në parkingun e Restorant ... në mesin e disa automjeteve të parkuara në mënyrë të parregullt ishte edhe automjeti i personit B.Q., dhe deri sa ishin duke biseduar me të, aty është paraqitur i pandehuri N., i cili ka filluar të fjaloset me të dëmtuarin D., duke i thënë “keni qu krye, s’di qa po ju duket vetja, kështu edhe mua ma ke marr patentën po të njoh, ke qenë në shkollë me djalin tim, fale këtë person”, edhe pse fillimisht i është tërhequr vërejtja se duhet të largohet ose të vendos maskën mirëpo i njëjti ka refuzuar, pasi kanë përfunduar me shqiptimin e gjobës, është paralajmëruar se duhet të arrestohet pasi kishte refuzuar të paraqes edhe dokument të identifikimit gjatë arrestimit, në atë moment me vrap afrohen të pandehurit B., dhe Sh. të cilët i’u vërsulen të dëmtuarve ku fillimisht i pandehuri B., me dorën e djathtë e kap për qafe të dëmtuarin D., e tërheq nga mbrapa, duke rrezuar në tokë, më pas i pandehuri Sh., e godet disa herë me shkelma në fytyrë, të njëjtit vazhdojnë duke e goditur derisa vijnë në ndihmë zyrtarët e tjerë policor, të cilët detyrohen të përdorin forcën duar thatë për ti arrestuar të pandehurit, me ç’rast të dëmtuarit D.SH., iu shkaktojnë lëndime të rënda trupore, lëndime këto të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B., të datës 20.07.2020.

**-Me çka kanë kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

#### **I akuzuari Sh.H.,**

**II.Sepse** me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pjesën e I-rë të dispozitivit të aktakuzës e sulmon personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe atë të dëmtuarin A.T., zyrtar policor në Gjakovë në atë mënyrë që ditën kritike deri sa të pandehurit Sh. dhe B.H., sulmonin duke e goditur të dëmtuarin D., gjatë përleshjes i dëmtuar A., kishte shkuar për ti ndihmuar të dëmtuarit duke e larguar të pandehurin Sh. i cili e godiste të dëmtuarin D., deri sa i pandehuri B., vazhdonte të mbante për qafe të dëmtuarin, i pandehuri Sh. i cili gjatë kacafytjes ishte mbi te e sulmon duke goditur me grushta në kokë, fytyrë dhe pjesë tjera të trupit deri sa i dëmtuari ka arrin të ngritët dhe pasi është tërheq mbrapa ka përdor sprejin me qëllim të futjes së tij në kontroll, më pas në ndihmë kanë shkuar edhe zyrtarët e tjerë policor, të cilët detyrohen të përdorin forcën duar thatë për ti arrestuar të pandehurit, me ç’rast të dëmtuarit A.t., i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B., të datës 20.07.2020.

**-Me çka ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 69, 70, dhe nenit 76 79, dhe neneve 402 par.6 lidhur me par.2 dhe 1 lidhur me nenin 31 dhe neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së, të akuzuarve iu shpall dënimet si vijon:

- **Të akuzuarit SH.H.,** i shqipton veç e veç dënimet për secilën veprë penale dhe atë:
- **Për veprën penale nën. I** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej një (1) vite, e tetë (8) tetë muaj.
- **Për veprën penale nën II**, të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit i:

## G J Y K O N

### **TË AKUZUARIN B.H.,**

**ME DËNIMIN ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) vite, e shtatë (7) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.15.07.2020 deri me dt.03.02.2021, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **TË AKUZUARIN SH.H.,**

**ME DËNIMIN UNIK ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.15.07.2020 e gjerë me dt.03.02.2021, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: **D.SH., dhe A.T.**, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Të akuzuarit B., dhe Sh.H., obligohen që të paguajë shpenzimet procedurale penale dhe atë për ekspertizë mjeko ligjore secili veç e veç shumën prej nga njëqind (100) €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga njëqind (100) € si dhe shumën prej pesëdhjetë (50) € secili veç e veç në emër të kompensimit të viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

### **B) PJESA LIRUESE**

**Ndaj të akuzuarit N. HAJDARAJ**, në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së.

## L I R O H E T N G A A K U Z A

**III.Sepse** me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pjesën I-rë të dispozitivit të aktakuzës në bashkëveprim me njëri tjetrin e sulmojnë personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe atë të dëmtuarin A.T., zyrtar policor në Gjakovë në atë mënyrë që ditën kritike deri sa të pandehurit Sh., dhe B. H., sulmonin duke e goditur të dëmtuarin D., gjatë përleshjes i dëmtuar A., kishte shkuar për ti ndihmuar të dëmtuarit duke e larguar të pandehurin Sh., i cili e godiste të dëmtuarin D., deri sa i pandehuri B., vazhdonte të mbante për qafe të dëmtuarin, i pandehuri N., me duar nga pas e shtynë të dëmtuarin A., i cili rrëzohet në tokë ndërsa më pas i pandehuri Sh., cili gjatë kacafytjes ishte mbi te e sulmon duke goditur me grushta në kokë, fytyrë dhe pjesë tjera të trupit deri sa i dëmtuari ka arrit të ngritet dhe pasi është tërheq mbrapa ka përdor sprejin

me qëllim të futjes së tyre në kontroll, më pas në ndihmë kanë shkuar edhe zyrtarët e tjerë policor, të cilët detyrohen të përdorin forcën duar thatë për ti arrestuar të pandehurit, me ç'rast të dëmtuarit A.T., i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B., të datës 20.07.2020.

**-Me çka kishte për kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

**- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

## **A r s y e t i m**

### *1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve*

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.83/2020, të datës 14.09.2020, kundër të akuzuarve b.H.,nga fsh., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari SH.H., nga fshati..., Komuna e Gjakovës, për shkak veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarit N.H., nga fshati .... Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuarit B.H., SH.H., dhe N.H., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilën ngarkohet me akuzë.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ka përgatitur në formë të shkruar, duke i propozuar gjykatës që të jetë pjesë e këtij procesverbali, ku nga një kopje iu dorëzojë palëve në procedurë dhe gjykatës (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.06.2024).

I dëmtuari D.SH., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe po ashtu fjalën përfundimtare e kam përpiluar në formë të shkruar, ku nga një kopje iu dorëzojë palëve në procedurë dhe trupit gjykues, propozojë që e njëjta të jetë pjesë përbërëse e këtij procesverbali (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.06.2024).

Mbrojtësja e të akuzuarit B.H., av.Mone Syla në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar nga një kopje iu dorëzojë palëve në procedurë dhe trupit gjykues, duk propozuar gjykatës që të jetë pjesë e këtij procesverbali, dhe të njëjtën e elaborojë para trupit gjykues (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.06.2024).

I akuzuari B.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të parashtruar nga mbrojtësja ime dhe nuk kam tjetër se çka të shtojë.

Mbrojtësja e të akuzuarit SH.H., av. Edona Sina në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar nga një kopje iu dorëzojë palëve në procedurë dhe trupit gjykues, duke propozuar gjykatës që të jetë pjesë e këtij procesverbalit, dhe të njëjtën e elaborojë para trupit gjykues (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.06.2024).

I akuzuari Sh.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të parashtruar nga mbrojtësja ime dhe nuk kam tjetër se çka të shtojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.H., av.Egzon Doli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fjalën përfundimtare e kam përgatitur në formë të shkruar nga një kopje iu dorëzojë palëve në procedurë dhe trupit gjykues, duk propozuar gjykatës që të jetë pjesë e këtij procesverbalit, dhe të njëjtën e elaborojë para trupit gjykues (shih fjalën përfundimtare bashkangjitur procesverbalit të dt.06.06.2024).

I akuzuari N.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë deklarinimin e mbrojtësit tim dhe tjetër nuk kam se çka të shtojë.

## 2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse të akuzuarit B., Sh., dhe N.H., nuk e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova: ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve - të dëmtuarit D.SH., dhe A.t., si dhe dëshmitarët B.Q., b.B, Dr.I.E., dhe Dr.B.J.,dhe ekspertin mjeko ligjor Dr.F.B., dhe ka administruar provat materiale që janë propozuar nga palët dhe atë: Raporti fillestar i incidentit të policisë së Kosovës me numër të rastit 2020-EA-788 të datës 15.07.2020, Raporti i oficerit policor V.V., të datës 15.07.2020, Raportit i oficerit policor J.O., të datës 15.07.2020, Raportit i oficerit policor H.M., të datës 15.07.2020, Raportit i oficerit policor E.K., të datës 15.07.2020, Raporti i hetuesit policor P.P., të datës 15.07.2020, Raporti i oficerit policor j.O., të datës 15.07.2020, Raporti i oficerit policor J.O., të datës 15.07.2020, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.07.2020, Mendimi i ekspertit mjeko- ligjor Dr. F.B., të datës 20.07.2020, Raportit i vendit të ngjarjes të përpiluar nga policia e Kosovës si dhe foto albumi lidhur me vendin e ngjarjes, shikimi i 25 fotove në formatin A4 në formatin bardh e zi, lidhur me lëndimet e të dëmtuarve, dhe Video incizimit si provë në vendin e ngjarjes, - Fletë lëshimit me epikrizë me nr.87, lista e amzës në emër të dëmtuarit D.SH., konstatimi i datës 16.07.2020 i përpiluar me dorëshkrim nga dr. B.J., analizat për të dëmtuarin së bashku me raportin kthyes nga diagnostika, si dhe fletë lëshimi i Repartit të emergjencës me nr. prot 9277, i datës 15.07.2020 në emër të dëmtuarit DSH., si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve B,H, SHH., ndërsa i akuzuari n.H., në rigjykim është mbrojtur në heshtje.

### 2.1. Deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1 **I dëmtuari D.SH.**, gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: punoi si zyrtar policor përkatësisht si zyrtar patrullues pranë Stacionit Policor në Gjakovë, ku si zyrtarë patrullues i kemi të gjitha angazhimet policore duke përfshirë thirrjet e qytetarëve, aksidentet, gjobat e trafikut, të gjitha inicimet fillestare të rasteve, me dt.15.07.2020 kam qenë në vendin e punës, kam qenë në detyrë zyrtare prej orës 08:00 deri në ora 16:00, dhe në këtë periudhë të verës kam qenë ekskluzivisht i angazhuar vetëm për gjobat të komunikacionit për parkingjet e pa rregullta dhe gjitha llojet tjera deri në qasje në komunikacion, kam qenë së bashku me kolegun A.t., me datën 15.07.2020, pasi që kemi dalë prej stacionit policor, kemi vazhduar drejtë qendrës dhe pas rreth 150 metrave, lokacioni i parë ku jemi ndaluar për lirim të trotuarit ka qenë trotuari përballë

restorantit “...”, në mesin e shumë automjeteve të parkuara në mënyrë të parregullt ishin edhe dy automjete të cilat e kishin të bllokuar trotuarin tërësisht. Në mesin e tyre ka qenë një automjet . . . dhe një automjet “... ” me rimorkio me targa ....., pasi që kemi ndaluar në atë lokacion kanë dalë dy shoferet e këtyre dy automjeteve ku unë i kam marr dokumentet shoferit të automjetit . . ., ndërsa kolegu A., të automjetit tjetër, pronarët në ato momente nuk i kam njohur mirëpo më vonë kam kuptuar se bëhet fjalë për automjetit . . . që ka qenë e pronarit “.....”, ndërsa automjeti tjetër ishte pronë e tani dëshmitarit ....nga Prizreni, pasi që i kam treguar arsyen e gjobës të pronarit të automjetit “. . .”, i njëjti gjatë gjithë kohës gjatë shqiptimit të gjobës më është drejtuar me fjalët pse nuk po i hekni kerret tek....., pse nuk po i hekni tek ..... dhe pse vetëm te unë vini, gjatë kësaj kohe nga restoranti “...”, ka ardhur një person i cili deri në ato momente ka qenë i panjohur për mua më vonë e kam kuptuar se bëhet fjalë për këtu të akuzuarin N.H., dhe i njëjti më është drejtuar me fjalët se “ çka keni qu kry shumë, çka po ju duket vetja, edhe mu ma ke marr patentën, “ashtu që unë ju kam drejtuar me fjalët që duhet të largohet pasi që është duke na penguar dhe të vendosë maskën mbrojtëse pasi që ishte duke ma rrezikuar edhe shëndetin tim, ashtu që të njëjtin disa herë e kam urdhëruar që të largohet mirëpo i njëjti nuk është larguar dhe më ka thënë se “kam maska boll”, unë kam vazhduar shqiptimin e gjobës për automjetin X5 dhe pasi që kam përfunduar me të i kam kërkuar N.H., që ta prezantoi një dokument identifikimi. I njëjti ka refuzuar që të ma prezantoj dokumentin e identifikimit dhe pastaj unë i kam thënë që do të arrestohet deri në identifikimin e tij. Në ato momente e kemi kapur së bashku me kolegun tim A.,në duar që të ia vendosim prangat mirëpo i njëjti ka refuzuar duke i larguar duart, në një moment derisa ishim duke ia vendosur prangat N., pa pritur dhe pa e vërejtur prapa shpinës me dorën e djathtë më ka kapur një person të cilin nuk e kam parë dhe më ka tërhequr mbrapa duke më rrëzuar dhe pasi jam rrëzuar në ato momente më ka goditur personi Sh.H., të cilin e kam parë me shkelëm në fytyrë, nuk më kujtohet sa herë më ka goditur më duket se dy herë dhe gjatë tërë kësaj kohe jam sharë dhe ofenduar nga personi i cili më vonë e kam kuptuar se quhet B.h., duke më thënë “a po e sheh se ta qimë nënën”, në ato momente kolegu A., është afruar dhe e ka kapë S.h., për ta larguar dhe të njëjtit kanë vazhduar përlëshjen prapa shpinës time, prej momentit që jam kap me dorë në fyt nga B., e deri në momentin që kanë arritur kolegët të tjerë dhe e kanë larguar, unë kam qenë i shtrirë në tokë ashtu që i njëjti ka qenë prapa meje dhe për asnjë moment nuk më ka lëshuar duke më ngulfatur në fyt. Gjatë kësaj kohe unë më shumë kam qenë pa frymëmarrje pasi që shtrëngimi ka qenë me tërë fuqinë e tij dhe që po të mos ishin kolegët të tjerë që do të vinin me kohë dhe shumë shpejtë unë nga ajo ngulfatje do të kisha pasoja shumë të rënda apo do të isha edhe i vdekur. Me të akuzuarit nuk i kam njohur. Përveç tre të akuzuarve kanë qen edhe dy pronarët e automjeteve, për tjerët nuk kam parë ngase kam qenë në gjendje të rëndë, për pronarin e automjetit . . . unë nuk i kam vërejtur se kanë qenë të përfshirë në rast dhe nuk kam parë se a kanë vepruar diçka pasi që tërë ngjarja ka ndodhur në një periudhë shumë të shkurtër kohore. Prokurori ka pyet se në raport me ju cili ka qenë roli i të pandehurit N., apo çka ka vepruar. Dëshmitari ka deklaruar se unë nuk e kam vërejte që i njëjti ka vepruar diçka në raport me mua përveç refuzimit të dokumentit për me dhënë siç theksova më parë dhe refuzimit të arrestimit. Ka shtuar se pasi që kanë ardhur kolegët dhe ma kanë larguar nga fyt B., unë jam ngritur dhe nuk më kujtohet asgjë tjetër përveç se e kam vërejtur automjetin e ambulancës i cili kishte qenë në rrugë dhe kamë shkuar dhe kam hypur në te dhe jemi nisur në drejtim të spitalit, kam qëndruar në spital jam hospitalizuar dhe sa më kujtohet kam qëndruar 7 ditë, për shkak të lëndimeve që kam marr nga sulmi i këtyre dy personave. Prokurori ka pyet se ju thatë se fillimisht nuk i keni njohur fizikisht të akuzuarit, tani po ti shihni me leje të trupit gjykues a mund ti identifikoni se cili është N., cili është B., dhe cili është Sh.,. Dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor sipas radhës i ka identifikuar të gjithë të akuzuarit pra e identifikon të akuzuarin B., Sh., dhe N., Lidhur me gjobat dëshmitari ka deklaruar se nuk më kujtohet mirëpo pas një kohe pasi që kam verifikuar në sistemin e policisë që gjashtë vite që punoi në stacionin policor në Gjakovë kam vërejte se N., ishte gjobitur një herë nga ana ime, po ashtu edhe B.,ndërsa Sh.,i nuk e kam vërejte

që ka ndonjë gjobë nga ana ime. Mbrojtësi i të akuzuarit të parë av.Sylë Hoxha ka pyet se a ju kujtohet i mbrojturi imë B., a ju ka goditur ndonjëherë gjatë asaj përlëshje dhe nëse po ku dhe me çka. Dëshmitari ka deklaruar se nuk më kujtohet që më ka goditë përveç që më ka kapë për qafe dhe më ka ngulfat. Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Feride Xani ka pyet se ju thatë se jeni rrëzuar në momentin kur keni ra në tokë, në çfarë pozicioni keni ra. Dëshmitari ka deklaruar se fillimisht në shpinë pastaj kam ra në krah përkatësisht në krahun e djathtë dhe sulmi ka zgjatur shumë pak sekonda pra mund të them as një minuta i plotë se po të kishte zgjatur më gjatë si pasojë e ngulfatjes do të isha i vdekur, ndërsa nuk e di që ka pasur ndonjë motiv. Dëshmitari ka deklaruar se pasi që më ka goditë Sh., A., ka ardhur e ka kapë Sh., pra kemi qenë duke u përlëshje unë kam qenë i shtrirë për tokë dhe Sh., e kam pasur për ballë dhe ka ardhur A. dhe e ka kapë dhe duke u përlëshje kanë vazhduar prapa shpinës time por unë nuk kam parë përmbropa mënyrën e përlëshjes. Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë av.Prek Kola ka pyet se ju a e keni parë që N., e ka goditur apo shtyrë të dëmtuarin kolegun tuaj A.T.,. Dëshmitari ka deklaruar se e thash edhe më herët dhe po e them edhe tash se rasti ka ndodhur prapa shpinës time dhe nuk kam pasur si ta shoh. I akuzuari i tretë ka pyet se a kam kërkuar nga ju që ta falni B.Q, mos ti shqiptoni gjobë. Dëshmitari ka deklaruar se nuk më kujtohet ngase përveç B.Q që ka kërkuar që ta fali nuk më kujtohet se ju keni kërkuar. Dëshmitari ka deklaruar se ne të dy kemi qenë në trotuare pra në anën e majtë timen e kam pas automjetin . . , po ashtu pronarin e automjetin këtu B.Q., në anën e djathtë ka qenë kolegu A., dhe B.Q, unë kam qenë duke i shqiptuar gjobë . . . , ndërsa dokumentet e xhipit tjetër pra të B.W., i ka pasur kolegu imë A.,, dhe hapësira në mes dy kolegëve ka qenë 3-4 metra, dhe që të dy këta personat pra pronarët e automjetit kanë dalë menjëherë dhe kontakti me ta ka qenë i menjëhershëm dhe në vazhdim. Ka shtuar se më ka tërhequr mbrapa jemi rrëzuar që të dy dhe ai tërë kohës ka qenë prapa meje dhe nuk më kujtohet detalisht se si kam ra, ashtu që unë kam ra në shpin dhe nuk më kujtohet që a kam ra në tokë apo përmbi të ngase nuk më kujtohen detajet por e di se kur jam kthyer në anën e djathtë ai ka qenë mbrapa meje dhe unë kam qenë në pozicion i shtrirë në krah dhe kam qenë i kapur për fyti kur më ka goditur Sh.,, disa herë ka qenë me dy apo më shumë, nuk më kujtohet dhe ka qenë vetëm me shqelm, lëndimet kryesore i kam pasur në hundë ndërsa kam pasur lëndime në hundë, shpine, fyte dhe disa pjesë të trupit, mbasi jam kthyer në krah këtë e kam pasur mbrapa dhe kam qenë i ngulfatur dhe trupi imë ka qenë i mbështetur për trupin e tij dhe nuk e kam parë pozicionin e tij saktë. Po ashtu në rigjykim i njëjti ka deklaruar mbesë në tërësi pranë deklaratës së dhënë me dt.10.12.2020 duke sqaruar edhe njëherë ditën kritike fillimisht kemi kontaktuar me N., fjalët në detale nuk më kujtohet, por disa herë i kam kërkuar që të largohet pasi që nuk ka qenë i përfshirë me punën që kemi qenë duke e bërë. N., ka ardh për me e fal personin që isha duke e gjobitur B.Q.,. Pasi që ka refuzuar me u larguar i kemi kërkuar dokumentin e identifikimit disa herë, i njëjti ka refuzuar me e dhënë letërnjoftimin, atëherë ne e kemi njoftuar se do të arrestohet për mos dhënien e dokumentit. Biseda ka qenë e tensionuar duke na thënë se keni qu kry, çka po ju doket vetja, edhe mu ma ke marrë patentin ma herët, këto kanë qenë disa fjalë të cilat po më kujtohen, vazhdon se pasi që është njoftuar se do të arrestohet, kemi marrë për ta arrestuar, i njëjti ka rezistuar arrestimin duke na i larguar duart, duke i shtyrë, në ato momente kanë ardhur dy persona nga prapa shpine që nuk kanë qenë prezentë në vendin ku ka filluar ngjarja, ku njëri nga ta më ka kap me dorën e djathtë në qaf-fyt, më ka shtrënguar dhe më ka tërhequr mbrapa, jam rrëzuar në pjesën e pasme, mandej në ato sekonda duke u munduar me u liruar prej ngulfatjes, jam kthyer në krahun e djathtë, pastaj tjetri që ka qenë me te Sh., e kam parë duke më goditur me shkelm në fytyrë. Kur më ka goditur Sh., i akuzuari B., e ka pasur dorën ende në fyt deri sa kanë ardhur policët tjerë në ndihmë. Sh., e mbajë mend se më ka goditur dy herë në fytyrë tek hunda, por saktësisht nuk e di pasi që kam qenë i ngulfatur. B., ka qenë i shtrirë mbrapa meje duke më mbajtur. Prej momentit kur jemi përlëshur me këta veprimet e N., nuk i kam parë. Kur me ka goditur Sh.,, aty ka ardhur kolegu A.,se a e ka shty a e ka tërhek Sh., nuk e di dhe kanë vazhduar në pjesën pas meje, ku unë nuk e kam parë pasi që kam qenë i mbuluar me gjak dhe i ngulfatur,

shton se pas disa sekondave kanë ardhur edhe disa policë tjerë, se kush kanë qenë nuk e di, po në ato momente e kanë kap dhe e kanë larguar B., prej meje, kur jam qu në këmbë e kam parë kerrin e ambulantes dhe kam shkuar tek kerri i ambulantes pasi që kam qenë i gjakosur. B., e kam pas mbas, i njëjti më ka shajtë dhe fjalët detalisht nuk më kujtohen, po ashtu shton se para fillimit të sulmit nuk kemi diskutuar asgjë. Nuk kam parë as veprimet e N., që kanë të bëjnë me ndalimin apo ndaljen e përleshjes. Fillimisht para se t'ia lypim dokumentin i kemi kërkuar që të largohet, pasi që nuk ka qenë i përfshirë, po ashtu ka qenë koha e pandemisë që ka qenë obligative mbajtja e maskave dhe i njëjti nuk ka pasur maskë, për me e ruajt shëndetin tonë i kemi kërkuar që të largohet dhe mos të na ofrohet afër, pasi që i njëjti ka refuzuar disa herë që të largohet atëherë ia kemi kërkuar dokumentin e identifikimit, pasi që ka refuzuar edhe dokumentin me e prezantuar edhe fjalëve në vazhdimësi që i ka thënë të cilat i ceka më lartë, dhe është bërë pengesë për ne atëherë e kemi njoftuar se do të arrestohet. Lëndimet kanë qenë në disa pjesë të trupit, në pjesën e fytyrës i kam nga goditjet me shkelm nga Sh., ndërsa gërvishtjet tjera në dorë, në gju i bjen që i kam pas prej B., pasi që i njëjti më ka tërhequr. Nuk kom deklaru se jam ra me kokë mbrapa, në momentin kur më ka kap B., jemi ra që të dy mbrapa, nuk thash se kam rënë në pjesën e pasme të kokës në tokë. E kom pa Sh., kur më ka goditur, ndërsa B., më vonë e kom marrë vesh prej kolegëve që kanë ardhur në vendin e ngjarjes. Krejt ngjarja prej se ka nisur e deri sa ka përfunduar ka qenë çështje sekondash, dhe menjëherë si më ka rrëzuar në tokë, më ka goditur me shqelm dhe aty ka intervenuar A., pra ka qenë çështje sekondash. Pasi që më ka tërhequr, jam rrëzuar, më ka goditur Sh., atëherë ka ardhur A., dhe e ka tërheq Sh.in. Nuk e kam pasur përballë për shkak se këta kanë qenë mbi mua pasi që unë kam qenë në tokë, kam qenë nga ana e djathtë e nuk më kujtohet se a e ka tërheq apo e ka shtyrë. Ka qenë trotuari para restorant ...., të cilin parking e kanë shfrytëzuar klientët, këta kanë ardhur prapa shpinës time prej restorantit-lokalit. Në momentin që i kërkon disa herë me u larguar, dhe nuk largohet dhe kur i kërkon letërnjoftim, refuzon me e dhënë aty nuk ka bashkëpunim, ndrysh është nëse nuk e ka me vete apo e ka harruar, e ndryshe kur nuk donë me dhënë. Në momentin që refuzon një palë me e dhënë dokumentin, atëherë nga ana e jonë lind dyshimi se i njëjti është person i dyshuar apo person në kërkim dhe arrestohet. Në momentin që prezanton dokumentin verifikohet në bazë nga vendi i ngjarjes, ndërsa kur nuk ka dokument nuk kemi se si ta identifikojmë e verifikojmë në bazë, është procedurë që një person që nuk ka dokument, nuk i dihet identiteti duhet me u shoqëruar apo me u arrestuar varësisht prej situatës. Deri sa kam diskutuar me N., B.Q.,, ka qenë aty prezentë gjatë bisedës, ku nuk më kujtohet se çka ka thënë i njëjti, apo ka marr ndonjë veprim ndërsa gjatë momentit të kacafytjes nuk e ka pa që ka vepruar diçka. B.,nuk me ka goditur vetëm më ka mbajtur për qafe dhe më ka shtrirë për toke dhe me ka shajtur.

**2.1.2 I dëmtuari A.T.,** gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se po punoi si pjesëtarë i policisë së Kosovës në stacionin policor në Gjakovë, për momentin jam në Drejtorinë Rajonale në Gjakovë, si pjesëtar i reagimit të shpejtë, ndërsa në kohën kur ka ndodhur rasti kam qenë zyrtar patrullues i stacionit policor në Gjakovë më konkretisht kam qenë në njësinë e biçikletave, ku njësia e biçikletave është marr 99% është marr me komunikacion konkretisht për parkingjet e pa rregullta. Me dt.15.07.2020 po ka qenë ditë e punës, kam filluar punën në ora 08:00 në mëngjes, ashtu që bashkë me kolegun D., me biçikleta kemi filluar patrullimet në rrugët e qytetit, kemi qenë në patrullë së bashku me kolegun D., pra çdo herë po flasë si njësi e biçikletave, në rrugën "...u", kur kemi arrite tek restoranti "...", ka pasur shumë vetura të parkuara mirëpo dy prej tyre të cilat e kishin bllokuar në tërësi trotuarin jemi ndalë që të merremi me to sepse veturat tjera kishin lënë hapësirë të mjaftueshme për me kaluar njerëzit në trotuare ndërsa këto dy vetura por edhe konkretisht . . . x5" ngjyrë hiri dhe një gjip tjetër nëse nuk gaboi ka qenë me ngjyrë të kaltër, i pronarit B.Q apo .... nuk më kujtohet saktësisht. Fillimisht është dal pronari i veturës ..., përkatësisht pronari i restorantit "...", dhe të njëjtin D., ia ka kërkuar dokumentet dhe e ka njoftuar për arsyen për të cilat po ia kërkon dokumentet, ndërkohë është ardhur edhe pronari i këtij xhipit të kaltër dhe fillimisht unë e kam pyetur se a je pronari i kësaj veture dhe ai më tha po, pastaj ia



kam kërkuar patentë shoferin dhe lejen e qarkullimit ashtu që mi ka dhënë. Pastaj D., derisa unë po komunikoj me këtë pronarin e veturës kaltër pra B., D., veç ishte në përfundim të shqiptimit të tikitës të “. . . x5” dhe aty afër ka qenë edhe pronari i veturës, gjatë kësaj kohe është ofruar një person më në moshë dhe ka folur me D., dhe renditjen e fjalëve se çka i ka thanë ky person nuk më kujtohen saktë por i di saktë disa prej tyre që kanë qenë “ ka qenë mirë mos me i dënuar, s’jeni ka bëni mirë, keni qua krye, ti më ke dënuar edhe mu, ma ke marr patentën” dhe këto fjalë ia ka drejtuar fillimisht D., dhe jam munduar me këtë personin që të komunikoi me të dhe ta tërheqë nga vetja dhe më shumë për hatër të moshës së tij ngase ishte më në moshë dhe unë iu kam drejtuar me fjalët se ju nëse keni ankesë nuk është vendi për me bë ankesë këtu dhe të lutem shko në stacion dhe personi në fjalë vetëm ka filluar të nervozohet. Pastaj D., ju drejtuar me fjalët se qite maskën derisa po komunikojmë se ishim afër ashtu që i njëjti refuzoi dhe tha “se nuk dua me e qitë” dhe përsëri më kujtohet shumë mirë se në mënyrën më të mirë të mundshme unë iu kam drejtuar me fjalë “se është obligative mbajtja e maskës” dhe qysh po e mbajmë na 8 orë në orare të punës dhe në biçikletë mbaje ashtu edhe ti. Pastaj D., ia kërkuar letërnjoftimin, i njëjti ka refuzuar me ia dhanë letërnjoftimin dhe me ia dhënë emrin duke i thënë se ska shka ju duhet juve emri imë dhe në momentin që disa herë është lutur me fjalët se ma jep letërnjoftimin ai çdo herë ka refuzuar dhe mund të them se minimum 5 herë i kam kërkuar vetëm unë letërnjoftimin dhe ka refuzuar dhe pastaj D., i ka thanë që nëse ju nuk prezantoni një dokument identifikimi duhet me të arrestuar dhe me të shoqëruar në stacionin policor që ti marrim shënimet e tua dhe i njëjti prapë ka refuzua dhe bashkë me D., e kemi marr për me e arrestuar ashtu që unë kam qenë në anën e djathtë, D., në të majtë dhe zotëria në mes, dhe unë ia kam kap dorën e majtë ngase unë atë e kam pasur përballë ndërsa di e ka kapur dorën e djathtë të tij dhe ende pa e futur në kontroll për të ia vendosur prangat kanë ardhur dy persona njëri prej tyre me dorën e tij të djathtë e ka kapur D., në qafë, e ka tërhekur D., mbrapa dhe e ka rrëzuar ndërsa tjetri fillimisht e ka goditur me shqelma në fytyrë dhe në këtë kohë unë e kam lanë këtë personin që ishim duke e arrestuar dhe kam shkuar për të ia hequr personin që ishte duke e goditur D., pra këtë personin që ishte duke goditur me shqelm dhe kur kam shkuar afër për me e kap dhe largu më ka shty dikush përmbas dhe ky personin që godiste D., është ardhur drejt meje, më ka shty dhe e ka shfrytëzuar atë pjesën mbrapa dhe më ka goditë edhe mua dhe unë jam rrëzua dhe më ka goditur në trup dikund, kur jam rrëzuar jam rrëzuar në shpinë dhe ky personi ashtë ardhur mbi mua dhe më ka goditë me grushta në fytyrë, personi që e kapi për qafe D., ka qenë ndërtim i mesëm trupor, jo i gjatë dhe ka qenë rreth 35 deri 40 vjeçar, ndërsa ai që e godiste ka qenë djalë i ri mund të them i moshës time, mund të them 2-3 vjet me i vjetër se unë dhe struktura e tij ka qenë sikur e atij personit tjetër. Dëshmitari ka shtuar se jo nuk i kam njohtë as nuk i kam takuar kurrë përveç personit më në moshë që e potencova e që më vonë e kam kuptuar që është i akuzuari N., një ditë në mëngjes derisa kam qenë duke ardhur në punë, në mëngjese dhe kam qenë duke pritur autobusin në fshatin ..... është ndalë dhe më ka pru me kerr të tij deri në stacionin policor në Gjakovë dhe kjo ka qenë mund të them një muaj para rastit ose më shumë. Dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor është kthyer nga të akuzuarit dhe thekson se B.H., e ka kapur për qafe D., i cili është i ulur në rreshtin e dytë ndërsa ky personi pra Sh., që është i ulur në rreshtin e parë e ka goditur D.,. Prokurori ka pyet se çka ka vepruar i akuzuari N., në drejtim të juaj. Dëshmitari ka deklaruar se deri në momentin e arrestimit pra kur ka rezistuar për arrestim nuk ka vepruar asgjë pra them se ska vepruar asgjë pastaj kur e kanë sulmuar D., këta dy tjerët mua më ka shty N., ndërsa në drejtim të D., unë nuk e kam vërejt se ka vepruar diçka. Ndërsa Sh., në drejtimin tim ka vepruar pasi që kur më ka goditë dhe jam rrëzuar dhe ka ardhur përmbi mua dhe me grusht më ka mëshuar në fytyrë, nuk e di sa ka zgjatë, kam arritur me larguar vetë, jam larguar disa hapa prapa dhe pastaj e kam përdorë sprejin dhe në atë moment kanë ardhur edhe policët tjerë, nuk kanë pas mjetë të fortë. Po kam shkuar në Spitalin Rajonal në Gjakovë. Në pyetjet e parashtruar nga mbrojtësja av.Feride Xani i njëjti ka deklaruar se e vërteta është deklarata që kam thënë në prokurori dhe ajo që po e them sot që po e them sot dhe raporti i policit është bërë

ditën e incidentit dhe nuk e kam pasur përqendrimin me e shpjeguar ngjarjen detalisht. Sipas jush në raportin e oficerit e keni shënuar se ka tentua me më goditë Sh., dhe më vonë në prokurori ju është kujtuar se ju ka goditur Sh., Dëshmitari ka deklaruar se e vërteta është edhe atë ditë edhe sot se më kujtohet saktë se ku më ka goditur Sh., dhe i njëjti më ka goditur në fytyrë përderisa kam qenë i rrëzuar dhe ka qenë mbi mua. Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë av. Prek Kola ka pyet se personi që ju ka shty mbrapa edhe një herë kush ka qenë dhe nëse po dhe a jeni rrëzuar ju nga kjo shtyrje. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë personi më në moshë që më vonë e kam kuptuar se ka qenë N., më ka shty dhe unë nuk jam rrëzuar aty kur më ka shtyrë ky mbrapa por kur ky personi tjetër më ka shtyrë dhe atëherë jam rrëzuar dhe jam sulmuar. Në momentin kur ju jeni shty nga ky personi mbrapa a keni mundur që të ktheheni dhe të identifikoni se kush ka qenë ky person apo si e keni kuptuar. Dëshmitari ka deklaruar se unë si kam shkuar që ta largoi atë personin për të ia hekur D., menjëherë ka ardhur personi që kemi qenë duke arrestuar ne, prapa meje ngase unë e kam lanë këtë dhe kam shkuar afër D., Ka pasur persona përreth një prej tyre ka qenë pronari i X5, pra pronari i “...” dhe po ashtu ka qenë edhe pronari i xhipit B., por këta në asnjë qastë nuk janë inkriminuar në rast. A e keni parë ju me sytë tuaj personin që ju ka shty mbrapa. Dëshmitari ka deklaruar se po e kam parë ngase si e kam lanë këtë i njëjti person ka ardhur aty. Nuk më kujtohet se në cilën pjesë të trupit më ka shtyrë dhe nuk kam pësuar lëndim nga shtyrja. Dëshmitari ka shtuar se po them vetura ka pas nuk e di në numër saktë sa dhe një prej tyre ka qenë edhe vetura e zotëri ut N., por që kanë lënë hapësirë të mjaftueshme për me kalua dhe këto vetura nuk i kemi ngucë ndërsa dy veturat tjera që e kanë bllokuar në tërësi trotuarin pra . . . ngjyrë hiri dhe Xhipi i zt. B., ne me këta dy persona jemi marr, unë personalisht në dorë kam pasur dokumentet e personit B., dhe kam qenë duke pritur që D. të përfundoi tiketën e pronarit të . . . dhe të marr bllokun e D., dhe të ia përfundoi tiketën personit në fjalë pra B., N., është drejtuar me fjalët mos e dëno, fillimisht për pronarit e X5, por pastaj edhe për personin tjetër B., ngase na tha se edhe kemi qenë bashkë duke ndejt dhe na ka thanë se ka ardhur prej larg, ndërsa B., dhe B., nuk kanë vepruar asgjë, kanë pritur me i marr dokumentet nëse i falë polici mirë nëse jo e ka pritur tiketën, gjatë përleshjes këta nuk më kujtohet asgjë as ku kanë ndejtë dhe as çka kanë bërë, nuk na ka ndarë askush derisa kanë ardhur patrullat e policisë. Kam reaguar me e liruar kolegun D/, nuk kam arritur që të largoi personin që e mbante për fyti ngase unë kam shkuar që të ia largoi personin që e godiste fillimisht dhe nuk kam arrit ngase pastaj jam sulmuar edhe unë. E kam përdorur sprejin në drejtim të dy personave atij që më ka goditur mua dhe peronit më në moshë, ndërsa kur e kam përdorur D., ka qenë ende i kapur për fyti. Në momentin që D., është sulmuar dhe ia kam vërejtur gjakun, kjo është periudhë e shkurtë kohore dhe e vetmja gjë që më ka ardhur në mend për momentin ka qenë që më ia larguar njërin. Sprejin e kam përdorë pasi që është larguar prej D., dhe pasi që më ka sulmuar mua dhe kur jam ngritë e kam përdorur sprejin. Kur ka ardhur mbështetja polciore që të tre të akuzuarit kanë qenë aty. Kam përpiluar të njëjtën ditë raport, pasi që jam kthyer nga Spitali, lëndimet i kam pasur në fyte pak dhe në pjesën e syrit, ndërsa Sh., me ka goditur me me grusht. Gjykata e ka pyet se ju thatë se nuk e dini me cilën pjesë të trupit më ka shtyrë dhe as në cilën pjesë të trupit më ka prekë, dhe meqenëse nuk po e dini me çka jeni shtyrë dhe në cilën pjesë të trupit ju ka prekur si po e bini përfundimin se jeni shtyrë mbrap Dëshmitari ka deklaruar se prej pozicionit ku kam qenë duke e larguar personin që e ka sulmuar D., me dorë në bel apo shpin, më ka ardhur një person dhe është ngritë edhe ky djali që ka qenë duke e sulmuar D., Sh., dhe më ka shty, më ka sulmuar jam rrëzua dhe pastaj më ka ardhur përmbi duke më goditë. Gjykata ka pyet se a e keni parë ju B., a e ka goditur ndonjë herë D., Dëshmitari ka deklarua se nuk e kam parë. Gjykata ka pyet se ju thatë se kah ora 09:00/h, ka ndodhur rasti ndërsa rreth orës 12:30, ju edhe e keni përpiluar raportin e policit, në raport ju thatë se kam pasur nevojë që të qetësohem dhe kjo periudhë po i bie prej rasti 3 orë e gjysmë afërsisht dhe ju në raport e keni shënuar edhe një herë se më vonë e kam kuptuar se derisa jam larguar jam rrëzuar në tokë ku kam pësuar lëndimet në dorën e djathtë dhe derisa kam qenë i shtrirë njëri prej tyre që më vonë e kam kuptuar që e ka pasur emrin

Sh.H., ka tentuar të më godas në fytyrë ndërsa sot po theksoni se Sh., më ka goditë në fytyrë, cila është e vërteta a ka tentua që të ju godas apo ju ka goditë. Dëshmitari ka deklaruar se më ka goditë. Gjykata ka pyet se pse nuk e keni shënuar në raport këtë. Dëshmitari ka deklaruar se nuk më kujtohet. Gjykata ka pyet se ngjarjen e goditjes a e keni pasur më të freskët atëherë apo tani. Dëshmitari ka deklaruar se tash e kam ngase jam relaksuar dhe e kam më të qartë ngjarjen. Në rigjykim ka deklaruar se kam dhënë një deklaratë më herët, por nuk mund të them a do të më kujtohen të gjitha pasi që kanë kaluar 4 vite, por do të mundohem, mbes në tërësi pranë deklarimeve të dhëna më herët lidhur me këtë çështje. Kemi shkuar tek Restorant..., tek trotuari, ku ka pasur makina të parkuara ku njëra ndër to e kishte bllokuar më shumë trotuarin sepse qëllimi jonë nuk ishte që ti dënonim personat por ta lironim trotuarin, tek ajo vetura e kaltër gjip nëse nuk gabojë, ka dal pronari i veturë, i kemi kërkuar dokumentacionin, në rregull ka qenë ai nuk ka rezistuar apo refuzuar, e kemi njoftuar se do të gjobitet për kundërvajtje në trafik, pastaj ka ardh një person tjetër dhe tha që jemi duke ndejtur bashkë, e me pas me e fal mos me e dënuar, ne veç kishim filluar me e kryer punën tonë, të njëjtit D., i ka kërkuar me u larguar pasi që nuk ka qenë vetura e tij, po ashtu nuk ka qenë palë, më kujtohet se u kone edhe Korona virusi dhe kemi qenë të detyruar me i mbajte maskat, ku D., ka kërkuar prej tij që të vendos një maskë derisa po komunikojmë, duke ia tërhequr vërejtjen për maskën, ku i akuzuari N., ka filluar me u nevrkos, ne kemi kërkuar prej tij që të na jep letërnjoftimin, aty tani ka pasur shumë fjalë tjetra, si po ma bëni për inat, ma keni dënuar djalin, ku këto nuk qëndrojnë, ku ai nuk na ka dhënë letërnjoftimin dhe ne i kemi thënë se do të arrestohesh nëse nuk e prezanton letërnjoftimin, në ato momente dy persona kanë dal prej lokalit, ku aty ishte një vazo e luleve, ku njëri prej tyre, nuk më kujtohet me cilën dorë por e di se e ka kap për fyti dhe e ka tërhek prapa, ku pastaj është rrëzuar me te ndërsa tjetri e ka goditur me shqelm në fytyrë, kam shkuar me e larguar njërin, ai më ka sulmuar mua ku më ka goditur në fytyrë, por meqë kanë kaluar ca kohë renditja e veprimeve nuk po më kujtohet, por në deklaratat e mëhershme të dhëna në prokurori dhe gjykatë e kam sqaruar këtë. Nuk jam i sigurt por nuk po më kujtohet, por B., më duket e ka kapur për fyti e ky tjetri e ka goditur. Personi që ka qenë duke u dënuar ka qenë bashkëpunues, na ka jap dokumentet, e ka pranuar kundërvajtjen, personat e dyshuar janë palë e dytë që kanë ardhur me intervenuar në këtë rast, pasi që vetura e tyre nuk ka qenë duke u dënuar për kundërvajtje. Nuk po më kujtohet, por e di që njëri e ka tërhequr përmbas dhe tjetri ia ka hi. Sh., më ka sulmuar pasi që unë kam shkuar me e tërhjek prej D.. Nuk ka rregullativ, është Ligji për policin konkretisht përdorimi i forcës dhe përshkruhet shumë mirë kur një personi i vendosen prangat, pra në rastin konkret deri sa nuk zbatohet urdhri i zyrtarit policor, refuzohet dhënia e letërnjoftimit për verifikim atëherë sipas ligjit je i obliguar me e prangos dhe me e shoqëruar në stacion policor. Ekzistojnë udhëzime administrative, veç sa mu kujtua edhe një arsye për të cilën është dashur që zotëria me u arrestua, për shkak të pengimit të personit zyrtar gjatë zbatimit të detyrës. Kur kemi tentuar me e arrestuar kanë ardhur dy personat. Nuk po më kujtohet, por ka qenë i domosdoshëm përdorimi. Kur e kam përdorur sprejin, në atë kohë kanë ardhur edhe policët, por nuk e di se nga cili veprim është liruar D.. Nuk më kujtohet se çka vepruar i akuzuari N., por më kujtohet se nuk më ka goditur N., ndoshta më ka shtyrë, por nuk jam i sigurt.

## 2.2 Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1 **Dëshmitari B.Q.,** gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: me datën 15.07.2020, kam qenë në Gjakovë dhe rreth orës 09:00 minuta kam qenë në restorantin "...", kam qenë i shoqëruar kam qenë me tre të akuzuarit pra N., B., dhe Sh, duke shtuar se kanë ardhur policia dhe unë e kisha parkuar veturën në mënyrë të pa lejuar jam ngritur dhe iu kamë drejtuar policit se qe po shkoj menirendi (menjëherë) nëse doni me më falë dhe polici më tha se jo nuk ka falje dhe pastaj është ngritur edhe N., dhe iu drejtuar policit jo mos e dëno se është duke shkuar dhe unë iu kam drejtuar N., se jo N., leje le ta bënë ky detyrën e vetë, atëherë polici iu ka drejtuar N., se ti pa

maskë nuk mundesh me diskutuar me mua se ta shqiptoi gjobën dhe të dënoi edhe ty dhe atëherë unë kamë qenë duke folë me telefon dhe derisa kam qenë duke biseduar me telefon me firmën time e kam dëgjuar një fjalë prej policëve se je i arrestuar dhe derisa unë e kam përfunduar telefonatën kur jam kthyer veç kur i kam parë të gjithë kishin qenë në tokë. Kanë qenë ratë policët dhe gjithë këta krejt bashkë në tokë. Prokurori ka pyet a kanë qenë duke u përleshje. Dëshmitari ka deklaruar se send nuk di nga se atëherë nuk e di a ka zgjatë një minuta apo dy kanë ardhur edhe përforcimet tjera. Prokurori ka pyet se ju kur e keni e keni dëgjuar fjalën e policit se jeni të arrestuar a mund të na tregoni ku kanë qenë dy të akuzuarit tjerë B., dhe Sh.. Dëshmitari ka deklaruar se kanë qenë të ulur në lokal. Unë nuk i kam parë kur janë ngrit nga tavolina ngase siç thash kam qenë i angazhuar me do punë të firmës. Prokurori ka pyet se ju në deklaratën në prokurori me datën 07.08.2020 keni dhënë një deklaratë në prokurori, ashtu që me leje të gjykatës prokurori e ballafaqon me deklaratën dhe duke përshkruar ngjarjen se si ka ndodhur ditën kritike në rreshtin e 13 të pasusit të parë në faqen 3 të deklaratës keni deklaruar se “derisa zyrtarët policor ishin duke e arrestuar N., i njëjti nuk iu ka dhënë duart dhe kam vërejtur janë ngritur B. dhe Sh., të përfshirë në përleshje”, ndërsa sot po thoni se nuk i keni parë as duke e arrestuar N., dhe as nuk e keni vërejte kur janë ngritur nga tavolina, cila është e vërteta. Dëshmitari ka deklaruar se e vërteta është kjo që po e them sot ngase për besë nuk po më kujtohet që e kam vërejte kur janë ngritur nga tavolina dhe nuk e di se si kam deklaruar në prokurori. Kur jam kthyer ngase unë kam qenë në telefon i kam parë të gjithë aty dhe njërin polic e kam parë afër betonit pra është një shkallë aty dhe ai ka qenë me gjak e të cilin nuk e di dhe nuk e njoh se cili ka qenë edhe sot me më thanë. Ka pasur gjak në fytyrë. Unë kam qenë mundem me thënë prej hyrjes tek “.” pra tek shkalla apo beton, unë mundem me them kam qenë deri në 5 metra prapa veturës, unë kam lëvizë kam mund me qenë edhe 1 metër por edhe 5 metra por unë po them përafërsisht dhe më vije keq nëse nuk jam i saktë por kështu ka qenë, jo mua nuk po më kujtohet vetëm nëse ka pasur ndonjë myshteri ngase personat që unë i njoh nuk i mbaj mend. I dëmtuari D.SH., ka pyet se a na ke nda neve gjatë përleshjes me të pandehurit. Dëshmitari ka deklaruar se dikën prej këtyre treve e kam tërhekë para se me ardhur policia por nuk e mbaj mend cilin dhe ju kam thënë moni se marre çka u bë se ishte për makinën teme puna. Mbrojtësi i të akuzuarit të parë av.Sylë Hoxha ka pyet se a ju i kujtohet dëshmitarit se gjatë asaj përleshje a e ka parë të akuzuarin B., dhe nëse po në çfarë pozicioni. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë ratë në krah së bashku me policin. Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë av.Prek Kola ka pyet se atë ditë gjatë asaj përleshje a e keni parë apo e keni vërejtur ju personalisht që i akuzuari N., ta ketë shty apo goditur ndonjërin prej zyrtarëve policor. Dëshmitari ka deklaruar se jo nuk e kam parë. Gjykata ka pyet kur kanë ardhur në vend të ngjarjes përforcimet tjera të policisë a kanë qenë të akuzuarit ende duke u përleshur me polic. Dëshmitari ka deklaruar se sa më kujtohet mua dytë kanë qenë në tokë B., e mbaj në mend se ka qenë ende tu u përleshje ndërsa a ka qenë N., apo ky tjetri Sh., nuk e mbaj mend. Po ashtu ne rigjykimi i njëjti ka deklaruar se unë gjatë asaj ngjarje që ka ndodhur unë kam pasur shumë telefonata, mu më kujtohet se kur kanë ardhur zyrtarët policor, pasi që makina ime ishte e parkuar jo në mënyrë të ligjshme por ka pasur edhe makina tjera, ku zyrtarët policor më kërkuan dokumentacionin, për me ma shqiptuar gjobën, iu luta iu thashë, se falmani se po e largojë menjëherë automjetin, këta nuk pranuar, ku pastaj N., e ndiu vetën keq, pasi që më kishte thirr, ai i luti zyrtarët, se a bon me e fal, këta nuk pranuan, dhe i thanë se ti nuk ke drejtë me fol se nuk ke maskë, ky i tha se mo se jam gjysh, e po të luti në mënyrë njerëzore se je i ri, D., i tha, se kam drejtë me të arrestuar, ai tha jo, dhe i tha se 3 herë je duke ma bërë të padrejtë, pastaj zyrtari D., i tha, se të arrestojë, e të ngrehi zhagë, pastaj pata një telefonat dhe agravojë situata. Pastaj tentova me hy në mes, i thashë N., shko se ia dhashë dokumentacionin dhe nuk ka problem le të ma shqiptojnë gjobë. N., nuk është larguar, pasi që zyrtari policor i tha jeni i arrestuar dhe ia kapi dorën. Unë e di se nga ana e djathtë dhe nuk e di se cili prej zyrtarëve ia ka kap dorën, pastaj veç i kam parë në tokë zyrtarin policor dhe N., afër, ku e kam tërhequr N., dhe pastaj kanë ardhur policia. Nuk e di, por ka qenë një beton aty përpara, e kom ndal N.,

dhe i kam thënë se marre. D., ka qenë në tokë dhe ka qenë i përgjakur, nga vendi ku ka ndodhur rasti kam qenë larg 1 metër apo 2 metra. Nuk e kam parë Sh.in duke e goditur me shkelm të dëmtuarin D.. Sipas asaj çka kam parë unë, sjellja e zyrtarit policor nuk ka qenë aq normale pasi që i tha se pa maskë nuk ki drejtë as me fol dhe herën e dytë të arrestojë dhe të ngrehi zhagë. Nuk ka pasur veprim rezistencë pasi që N., iu ka thënë se muaj me qenë gjyshi yt, edhe djalit i kam ndihmuar në shkollë në Pejë. Gjykata e ka ballafaquar me deklaratat e dhëna më herët në polici dhe prokurore, se të ngrehi zhagë, nuk e keni thënë asnjëherë? Dëshmitari ka deklaruar se nuk e di mu ka pashtjelluar, nuk e di. Gjykata e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori në faqen 3, keni deklaruar “se mu më ka ardhur një telefonat nga firma dhe deri sa isha duke biseduar në telefon kam dëgjuar se i kanë thënë N., , se je i arrestuar nga ky moment, deri sa zyrtarët policor ishin duke arrestuar N., i njëjti nuk iu ka dhënë duart dhe kam vërejtur se nga tavolina janë ngritur B., dhe Sh., të përfshirë në përlëshje,” a është e vërtetë kjo çka keni thënë në prokurori? Dëshmitari ka deklaruar se po është e vërtete.

**2.2.2 Dëshmitari B.B.,** gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kam dhënë një deklaratë në Prokurori me dt.18.08.2020 dhe ngeli pranë asaj deklarate. Me dt.15.07.2020, rreth orës 09:00 të mëngjesit kam qenë në restorant “.....” pasi që jam pronar. Dëshmitari ka deklaruar se zyrtarët policor në atë moment nuk kanë qenë pastaj më ka ardhur gruaja rreth orës 09-09:20, për me pi një kafe dhe automjeti ka qenë i madh Xhip dhe jam ulur brenda me gruan, kanë ardhur policia dhe i kanë lanë biçikletat nja 4 automjete me larg dhe kanë qenë dy polic me biçikleta, dhe unë i thash gruas se a e ke lanë automjetin keç, ajo më tha nuk e di, unë kam qenë brenda gjithmonë në lokal dhe kam dal dhe kam marr çelësin dhe kur kam dalë është e vërtetë se automjeti ka qenë i parkuar keç dhe ka ardhur njëri prej policëve dhe më ka kërkuar dokumentet dhe i kam thënë a banë me më falë pasi që jam pronarë i lokalit dhe lëvizti me atë automjet, nuk e ka diskutuar dhe më ka thënë ami dokumentet dhe unë i thashë nuk e kam një moshë për me u sjellë ashtu dhe mi ka marr dokumentet dhe kemi qenë duke ecur rrugës paralel dhe i kam thënë se nuk po i dënioni tek “....” qebaptorë përballë, për çdo ankesë i njëjti më tha se mund ta njoftoni Stacionin Policor, dhe është kthyer edhe një herë dhe më tha emrin e babës dhe i thash se nuk dua me ta tregu emrin i njëjti tha se ta sekuestroi patentën dhe pastaj duke ecur jemi ofruar tek automjeti tek shoku i N., duke biseduar, atëherë i tregova emrin e babës dhe ma shqiptoi një tiketë mirëpo sjellja ishte agresive. Tek automjeti i B., aty ka qenë N., dhe ma ka shkruar mu dënimin dhe më tha vazhdo, dhe në atë moment e kam dëgjuar N., duke i thënë falëm disa herë dhe i njëjti i tha se ty do ti shqiptoi tre dënime dhe atë moment kur i ka thënë se një e ke për maskë një për kerr dhe kur ju ofruar për me e kap për dore kam ngajt vrap dhe kam hyrë në lokal dhe i kam thënë gruas ik prej këtu dhe ia kam dhënë çelësin e veturës dhe derisa ajo ka hyp në makinë dhe derisa ajo jashtë ku unë i tregosha jam kthyer për me i hekë punëtorët e mi. Prokurori ka pyet se kur i ka thënë zyrtari policor i ke tre dënime çka ka veprua N.. Dëshmitari ka deklaruar se e kam dëgjuar se i ka thënë falëm, falëm dhe kur e ka kap për dore polici e ka kap N., e kam kuptuar se do të përlëshen. Prokurori ka pyet se pse e kuptove ti se do të ndodhë përlëshja. Dëshmitari ka deklaruar se polici nuk u tërhekte dhe mënyra e arrestimit nuk ishte në rregull pasi që e kapi për dore. Prokurori ka pyet se a ka pas ndonjë veprim tjetër prej policisë përveç që ia kanë kapur për dore. Dëshmitari ka deklaruar se jo, veç e kam dëgjuar N., se i ka thanë se në këtë mënyrë nuk ke shanse me më arrestua se jam babagysh, dhe unë jam tërhekur. Ndërsa të pandehurit B.... dhe Sh... kanë qenë në lokal duke pirë kafe, kanë qenë të ulur jashtë larg vendit ku ka ndodhur rasti 10 deri 15 metra dhe këta kur e kanë parë që ka donë me e arrestuar vëllain e vetë janë ofruar, pastaj unë duke i tërhek punëtorët e mi për me u largua kur jam kthyer i kam parë të gjithë të rrezuar në tokë. Prokurori ka pyet dëshmitarin se i dëmtuari D., a ka qenë i rrëzuar apo si ka qenë. Dëshmitari ka deklaruar se po, ka qenë i rrëzuar për toke ndërsa lëvizjet kanë qenë të shpejta dhe i kam parë të akuzuarit duke u sjell edhe të dëmtuarin tjetër. Prokurori ka pyet se në pjesën e procesverbalit të dhënë në prokurori në faqen 4 në pyetjen e prokurorit se çka keni

vërejte gjatë përleshjes dëshmitari është përgjigjur “D., është rrëzuar në tokë mbi D., nuk e di a ka qenë N., apo B.,” ndërsa sot po thoni që kanë qenë duke u sjell të gjithë, a mund të na sqaroni se kush ka qenë përmbi D., cila është e vërteta, deklarata e dhënë në prokurori apo kjo sot. Dëshmitari ka deklaruar se nuk e di se cili ka qenë. D... ka qenë i lënduar, ka pas gjak në fytyrë, ka pasur edhe gjak në tokë dhe pas përfundimit të hetimeve e kam pastruar, njollat prej gjakut që kanë qenë në tokë kanë qenë të dëmtuarit D.... Prokurori ka pyet se zyrtari policor tjetër, sa ka qenë larg kur ka ndodhur përleshja. Dëshmitari ka deklaruar se herën e fundit kur i kam parë kanë qenë të dytë së bashku, ka vepruar duke u cellur për me i larguar dy palët për me u nda pastaj nuk e kam parë. Kur kanë ardhur përforcimet unë kam qenë në lokal, ka ardhur një polic A.SH., i ka kërkuar kamerat dhe unë i thash nuk kam dhe i kam treguar se lartë tek banesa përballë lokalit ka kamera. I dëmtuari D.SH., ka pyet se cili ka qenë dënimi i tretë të cilët i kam thënë N., përveç maskës dhe dënimit të kerrit siç deklaruat ju. Dëshmitari ka deklaruar se kam me të arrestuar. I dëmtuari ka pyet se a i kam thënë këto fjalë në fillim të bisedës që kam biseduar me të. Dëshmitari ka deklaruar se derisa më ka shqiptuar dënimin mua ka dialoguar me mua dhe me N., ndërsa kur më ka dhënë dënimin mua i ka thënë këto fjalë. I dëmtuari A.T., ka pyet a i kemi dënuar të gjitha automjetet apo vetëm ato që ishin të parkuara keç apo të pa rregullta. Dëshmitari ka deklaruar se vetëm unë jam dënuar por ka qenë i parkuar edhe automjeti i B., keq, i cili i ka thënë policit falëm ndërsa automjetet tjera kanë qenë në vij. Mbrojtësi i të akuzuarit të parë av.Sylë Hoxha ka pyet se a mundesh me u sqarua sa ishte automjeti i juaj larg me atë të B.. Dëshmitari ka deklaruar se për afërsisht 10 deri në 15 metra. Mbrojtësi i të akuzuarit të parë av.Sylë Hoxha ka pyet se a të kujtohet se gjatë përleshjes i akuzuari B... në çfarë pozite e ke parë nëse e ke parë. Dëshmitari ka deklaruar se B... e kam parë herën e parë ka qenë në atë tavolinën të cilën e ceka më lartë dhe herën e mbrëmë kur e kanë arrestuar policia. Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Ferdie Xani ka pyet a mund të na tregoni se kush ka qenë në afërsi të D... gjatë këtij incidenti. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë vetëm N... para se me fillua përleshja ndërsa kur janë përleshje kanë qenë nëpër tokë. Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Ferdie Xani ka pyet a mbeteni pranë deklaratës së dhënë në prokurori se pranë D.. kanë qenë N... dhe B.... Dëshmitari ka deklaruar se po. Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë av.Prek Kola ka pyet dëshmitarin se prej momentin kur ka filluar përleshja e gjerë në përfundim a e keni parë N. duke goditur ndonjërin prej policëve. Dëshmitari ka deklaruar se jo, nuk e kam parë. Gjykata ka pyet a të kujtohet se gjatë kësaj përleshje i dëmtuari AT., a ka qenë i rrëzuar në tokë. Dëshmitari ka deklaruar se ndoshta është rrëzuar por unë nuk e kam parë ndërsa D... po ka qenë i rrëzuar. Gjykata ka pyet se ju deklaruat se të gjithë kanë qenë për toke. Dëshmitari ka deklaruar se derisa kanë ardhur përforcimet të gjithë kanë qenë për tokë e pastaj i kanë kapur dhe i kanë arrestuar, kanë qenë duke u përleshur në mes vete, dhe të gjithë të pandehurit kanë qenë në vendin e ngjarjes kur kanë ardhur përforcimet. Po të gjithë kanë qenë. Gjykata ka pyet se ju deklaruat se i keni larguar punëtorët, sa punëtorë kanë qenë atë ditë në punë. Dëshmitari ka deklaruar se kanë qenë dy një shankistë dhe një kamerier ndërsa punëtorët tjerë kanë qenë në kuzhinë si kamerier ka qenë D.G., ndërsa shankisti ka qenë Z.B., djali imë dhe nuk janë marr në pyetje këta prej policisë. Në rigjykim i njëjti ka dëshmuar se unë si pronar i Restorantit “...” kam qenë me automjet timin dhe kam qenë me i blerë disa gjëra për lokalin tim, dhe kur i kam lënë sendet i kam parë dy polic me biçikleta tek automjeti i jam, u ndal ky polici tek kerri im ndërsa ai tjetri ka shkuar në mes të parkingut dhe mi ka lyp dokumentet, unë i kam treguar se jam pronar i lokalit dhe kerri im nuk ka qenë i parkuar në mënyrë të rregullt dhe polici nuk ka fol asgjë, unë i thash se jam pronar dhe a bon me më fal, i njëjti më thoshte, dokumentet, atëherë ia kam dhënë dokumentet dhe më ka thënë se hajde tek ai kolegu më andej dhe ka filluar me ma shkruar dënimin, ku i ka ra afër makinës ku ka qenë N..., dhe duke me ma shkruar dënimin, e kam dëgjuar se zyrtari policor iu ka drejtuar N.... dhe i ka thënë, ti rri qitu, ndërsa mua ma ka dhënë letrën ndërsa N... i ka thënë se kam me të arrestuar në këtë moment, atëherë N... i ka thënë se jam babagjysh, djali im është shok i yt, iu ka lut për mos me e arrestuar, dhe i ka thënë se bima një patroll këtu se njerëzit nuk

e din se për çka jeni duke më arrestuar dhe kishte njerëz në terasë. Pasi që ia ka kërkuar dokumentet, dhe ai ia ka jap dokumentet, dhe pasi jam kthyer për me u largu. Pastaj i ka thënë N.... se kam me të arrestuar qitash dhe zhag kam me të ngre dhe unë jam tërhek se e kam ditë se ka me ndodh diçka dhe i kam larguar kamerierin dhe një shankistë dhe jam shku e kom qit kerrin tim dhe e kam shti në rrugë brenda. Pastaj kur kam ardhur i kam parë këta N... dhe policin në tokë edhe B.... i cili ka qenë ndërsa Sh... nuk e kam parë, dhe pastaj jam tërhjekur dhe nuk kam parë asgjë. Zyrtari policor A. e kam parë se i ka bërë dy lëvizje tjera por nuk e di se çka ka bërë saktësisht. N... i ka pasur duart përmbas. E kam parë skenën në fund, kur kanë ardhur edhe policët tjerë dhe i dëmtuari D.... ka qenë në tokë pasi që unë isha tërhequr. Nuk e kam parë Sh.in që e ka goditur D.... Unë si pronar i lokalit kam të drejtë për të u ndalur ndonjëherë dhe për ti shtirë sendet, dhe i kërkoja që të më fal, dhe ai vetëm më shikonte dhe thoshte, dokumentet, dhe për çdo vërejtje që e ke, këqyr ku e ke stacionin policor, e kjo sjellje e tij më është dukur nënçmuese, pasi që ai pasi që i thashë mirëdita, vetëm më shikonte. Unë e kam parë që janë gjuajtur polici D... me N..., pastaj është bërë shumë guzheb dhe nuk e kam parë se çka u bo më pastaj.

**2.2.3 Dëshmitari Dr.I.E.,** (specialist i ORL-së) gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se për pacientin D.SH., normal që kam harruar si rast por fatmirësisht e kam të ruajtur dokumentacionin mjekësor dhe sipas dokumentacionit pacienti ka qenë i shtruar për 5 ditë në repartin e ORL-së, është pranuar pas një aksidenti rrahje me frakturë të ashtit të hundës dhe një plagë në lëkur jashtë nga hunda, nga mjekët tjerë të cilët janë konsultuar në emergjencë me siguri janë të shënuara edhe ndrydhje në qafë, në parakrahun e djathtë në të dy gjunjët dhe gërvishtje në gjurin e djathtë, ky rast në ORL-së është reponuar fraktura që d.m.th. hunda ka dal në vendin e vet, pasi që ka qenë një thyerje dhe plaga është qep, ku pas 5 ditëve pacienti ka dal nga spitali në gjendje të mirë, kurse fiksimi nga jashtë me fllastera i ka mbajtur edhe 5 ditë tjera, kjo ka qenë gjendja e pacientit. Jam mjek specialist i ORL-së nga viti 2002. Sa i përket lëndimeve që po pyet avokatja çdo thyerje kategorizohet në lëndime të rënda por që mund të jetë me pasoja apo pa pasoja për jetën, në rastin konkret sipas dokumentacionit lëndimi ka qenë i rëndë kurse për vlerësim a ka apo nuk ka pasoja duhet një ekzaminim tjetër ose ekspertizë e gjendjes së çastit, thyerje ka pasur, operacionet çdo intervenim që bëhet në pacient quhet operacion, në këtë rast tek ky pacient është bërë reponim - operacioni me duar dhe instrumente dhe është pozicionuar hunda në vend, ka pasur ndërhyrje d.m.th operacion siç e shpjegova më lartë. Sipas fletë lëshimit është shënuar edhe nga radiologu – eksperti i radiologjisë Dr.B.J., që ka pasur frakturë të hundës pra ka qenë e konfirmuar fraktura e hundës. Unë nuk e bëjë vlerësimin, mirëpo çdo thyerje kategorizohet lëndim i rëndë. Intervenimi është bërë me duar dhe me instrumente ku kockat e vogla janë qit në vendet e veta të cilat kocka kanë qenë të thyera. Fraktura e ashtit të hundës. Unë bëjë një sqarim unë mbajë vetëm fletë lëshimit me epikrizë sa për vete, ndërsa dokumentacionit ruhet në arkiv të spitalit ku edhe në arkiv duhet të ekzistojë raporti i radiologut lidhur me frakturën, pasi që rëntgeni është bërë paraprakisht. Pas kryerjes së operacionit me duar dhe instrumente pacienti e ka pasur hundën e mbyllur për 5 ditë me gaza, kurse prej së jashtmi ka pasur të fiksuar me fllastera ndërsa gips nuk paskam vendosur pasi që nuk ka qenë e nevojshme, fashat në hundë janë mbajtur 5 ditë, dhe pastaj janë hequr, pastaj janë hequr fllasterat, ndërsa sa i përket gjendjes fizike i njëjti mund të ketë dhimbje, ka mund të dal të ec, vetëm aktivitetet fizike janë të ndaluara. Mobilizimi ka qenë vendosja e fllasterave nga jashtë hundës në mënyrë që të mos lëvizë hunda.

**2.2.4 Dëshmitari Dr.B.J., (Radiolog)** gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se sipas përshkrimit që e kam bërë është vetëm një frakturë e kockës së hundës, nuk kam përmendur shenja për dislokim të frakturës dhe pa ndryshime tjera evidente, bazuar në këtë raport që e kam lëshuar. Unë jam mjek specialist-radiolog që nga viti 2010 jam mjek i praktikës së përgjithshme i diplomuar kurse nga viti 2019 jam mjek specialist radiolog. Për mua është hera e parë që ndodhem në një situatë të tillë pasi që nuk kam përvojë të kësaj natyre dhe unë u bazova në atë

se çka kam shkruar dhe dhënë mendim, e kjo është bazuar në bazë të metodës ekzaminuese – rëngën. Dhe unë raportin e kam lëshuar duke u bazuar në një rëngën-fotografim. Pa rëngën unë nuk kisha mundur me e bërë këtë konstatim, pra donë të thotë se e kam parë rëngenin. Me sa di unë një kopje e diskut i ipet palës, ndërsa ekzaminimi mbetet në memorie të kompjuterit përkatës nga është bërë ekzaminimi. Edhe në raportin tim edhe në raportin e mjekut të ORL-është e përshkruar si frakturë e kockës së hundës, nuk është e precizuar. Konsiderojë që mund të ketë gjurmë por jo të konstatohet absoluti se ka pasur intervenim. Me rastin e intervenimit në frakturë ne nuk marrim pjesë, ne vetëm japim konstatime. Në bazë të dokumentacionin që po shoh, kam konstatuar se ka frakturë mirëpo nuk kam përmendur shenja për dislokim. Dallimi në mes të frakturës, pra fraktura është ndërprerje e kontinuitetit me apo pa zhvendosje, unë nuk e paskam përmendur me dislokim apo pa dislokim. Në rastin konkret besojë që nuk ka pasur pasi që nuk e kam përmendur, pasi që edhe diagnoza përfundimtare e Dr.I., qenka ashtu.

### 2.3 Deklarimi i ekspertit mjeko – ligjor

2.3.1 **Eksperti mjeko ligjore Dr.F.B.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në pyetjet e palëve në procedurë, Prokurori ka pyet se ju keni dhënë një mendim profesional lidhur me lëndimet trupore për të dëmtuarit D.SH., dhe A.T., ashtu që materialin që ju është dërguar juve për ekzaminim a ka qenë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të dhënë një mendim profesional lidhur me këtë rast. Eksperti ka deklaruar se po ka qenë i mjaftueshëm. Eksperti ka deklaruar se tek i dëmtuari D.SH., është konstatuar thyerje e kockave të hundës, plagë shqyese në hundë, ndrydhje të indeve të buta të qafës para krahut të djathtë të dy gjunjëve me gërvishtjen e gjurit të djathtë, të cilat kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Është kryer ndërhyrje kirurgjike që është bërë reponimi me duar ose manual dhe me instrumente mjekësore për ti kthyer në vend kockat e thyera të hundës dhe këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtime të përkohshme të shëndetit. Eksperti ka shtuar se mekanizmi i shkaktimit të këtyre dëmtimeve mund të jetë nga veprimi i një mjeti të fortë të drejtuar trupit apo me përplasje të trupit në një mjetë të fortë apo sipërfaqe, në mjetet e forta bëjnë pjesë grushti, gjuri, huri, shufra, murri etj. Prokurori ka pyet se veprimi me shqelëm në drejtim të një trupi dhe në rastin konkret a mund të konsiderohet si mjet i fortë. Eksperti ka deklaruar se po patjetër. Eksperti ka deklaruar se tek i dëmtuari A.. kemi të bëjmë me ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të majtë dhe bërrylit të dorës së djathtë gjithashtu të shkaktuara nga veprimi mekanik i një mjeti të fortë por si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore. Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Feride Xani ka pyet ekspertin se në ekspertizën mjeko ligjore të përpiluar nga ana e juaj në mendimin e dhënë ceket tek i dëmtuari D.Sh., plagë shqyese në hundë a mund të na shpjegoni mënyrën si shkaktohen, me çfarë mjeti mund të shkaktohen. Eksperti ka deklaruar se plagët shqyese janë dëmtime jo specifike të cilat mund të shkaktohen nga mjetet të ndryshme por që saktësisht nuk mund ta dimë prandaj edhe quhen jo specifike, në qoftëse nën lëkurë është një inde i fortë siç është ashti këto dëmtime mund të shkaktohen me grushte, me bërryl, me shkelmë duke e përplasur kokën në ndonjë objekt të fortë etj. Në rigjykim ekspertit mjeko ligjor Dr.F.B., ka deklaruar se tek i dëmtuari D.SH., janë konstatuar thyerje të kockave të hundës, plagë shqyese në hundë, ndrydhje të indeve të buta të qafës parakrahut të djathtë të dy gjunjëve dhe është kryer ndërhyrje kirurgjike për reponimin apo kthyerjen në vend të kockës së thyer të hundës, këto dëmtime kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, këto dëmtime shoqërohen me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Ndërkaq tek i dëmtuari tjetër A.T., janë konstatuar ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të majtë dhe bërrylit të dorës së djathtë gjithashtu të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë por si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, gjithashtu me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Jam specialist i mjekësisë ligjore, profesor i mjekësisë ligjore, përvojë si mjek 32 vjeçare, ndërkaq si specialist i mjekësisë ligjore përvojë



prej 25 vite. Unë nuk jam specialist i otorinolaringologjisë vetëm ata janë të thirrur që ti trajtojnë këto dëmtime të regjionit të hundës. Mjekësia ligjore është përcaktuar jo vetëm tek ne por gjithandej në botë të merret me vlerësimin dhe jo me trajtimin e dëmtimeve trupore dhe për rrjedhojë ne përcaktojmë natyrën e dëmtimeve, mjetin i cili i ka shkaktuar ato, dhe shkallën e rëndesës së dëmtimeve trupore bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, andaj një Orolist specialist i otorinolaringologjisë nuk e bënë këtë vlerësim të cilin e theksova më lartë. I dëmtuari D.SH., ka pësuar thyerje të kockës së hundës dhe kjo thyerje e kockës së hundës detyrimisht duhet të reponohet me intervenim kirurgjik, pra pjesët e kockës së thyer duhet të kthehen në vendin e vet, në qoftë se nuk kryhet një intervenim i tillë pasojat nga ky dëmtim mund të jenë të përhershme. Aty është qëllimi i ndërhyrjes kirurgjike që fragmentet kockore të thyera të kthehen në pozitë anatomike-natyrë se përndryshe thashë edhe më përpara pasojat nga kjo thyerje ngelen të përhershme. Nuk ka nevojë nga jashtë pasi që ata i kanë metodat për intervenime. Rengeni ose provat tjera imazherike nuk janë të detyrueshme për ne sepse interpretimin e tyre e bënë radiologu kompetent ndërkaq në rastin konkret tek thyerja e kockës së hundës nuk ka nevojë rëngën fare sepse specialisti i ORL-së vetëm me prekje të shalës së hundës e dinë a kemi thyerje apo jo. Shenjat dhe simptomat janë në përgjithësi individuale që varet nga shkalla e thyerjes se kockave të hundës, por zakonisht kemi të bëjmë me dhimbje, enjtje, skuqje, dhe pengesa në frymëmarrje për shkak të ç'vendosjes së fragmenteve kockore të cilat ndikojnë në kalueshmërinë e ajrit nëpër vrimat e hundës. Hunda në vend ka qenë por fragmentet kockore të thyera dhe janë kthyer në vend andaj quhet intervenim kirurgjik. Nuk ka nevojë ekspertiza të veçanta në raste të tilla sepse secili radiolog jo vetëm pas 3-4 vitesh por edhe pas 30 vitesh do ta dijë se një kockë e thyer është ngjitur por vendi ku ngjitet kocka detyrimisht krijon një kallus që donë të thotë vendi ku ngjitet është më i trashë se vendi për rreth, prandaj edhe pas shumë vitesh konstatohet se kocka ka qenë e thyer. Mekanizmi i shkaktimit të dëmtimeve trupore është dy llojesh, kur mjeti i fortë godet trupin dhe kur trupi përplasat në një sipërfaqe të fortë ose objekt të fortë, dëmtimet trupore si plagët shquese, thyerjet, gërvishtje, hematoma, konsiderohen dëmtime jo specifike sepse saktësisht nuk mund të dijmë se cili mjet i ka shkaktuar ato, në mjete të forta bëjnë pjesë grushti, gjuri, bërryli, shqelmi, shkopi metalik, shkopi i drurit, tulla, guri etj, ose themi në përgjithësi nga mekanizimi i veprimit të një force në mënyrë mekanike, sikur relievi i objektit karakteristik objekt p.sh. katrama e rrypit goditet në lëkur atëherë pasqyrohet si e tillë në lëkur edhe shenja është shëmbëlltjërë e rrypit prandaj edhe mund të përcaktohet, por në përgjithësi nuk mund të përcaktohet se cili mjet i ka shkaktuar ato. Element kualifikues në këtë rast është thyerja e hundës ndërsa lëndimet e tjera janë të natyrës së lehtë. Nëse nuk ka shenjë në trup nuk konsiderohet lëndim, por në mënyrë hipotetike në rast se kemi atëherë bënë pjesë në lëndim të lehtë trupor. Nëse dy arteriet karotide (gjumore) shtypen njëkohësisht për 10-15 sekonda personi bie në gjumë. Mund të shtypen të dy arteriet vetëm me njërën dorë kur dora e autorit bëhet lak dhe me parakrah shtyp njërën arterie ndërsa me krahe arterien tjetër.

#### 2.4. Propozimet e palëve në procedurë

Mbrojtësja e të akuzuarit të parë av. Mone Syla, ka propozuar se me rastin e marrjes në pyetje të ekspertit dhe dëshmisë së tij të dhënë pranë trupit gjykues dhe të pranishmeve në sallë u pa qartë se dëshmia e tij ishte devijonte me atë se çka ka ndodhur në realitet dhe në saj të gjitha atyre se çka u pyete dhe çka u përgjigje nuk argumentojë faktet dhe provat ligjore që i përkasin lidhje me lëndimet e marra dhe ekspertizën e elaboruar nga ana e tij, andaj e gjetur në këtë fazë pranë kësaj situate kërkojë nga trupi gjykues që lidhur me këtë rast të kërkohet super ekspertizë prej ekspertëve përkatës e jo si në rastin konkret nga përfaqësuesi i mjekësisë ligjore që faktikisht nuk i përket lëmisë përkatëse të intervenimeve të rasteve të tilla, dhe mendojë që nuk duhet ti

falet besimi kësaj ekspertize dhe të kërkohet një ekspertizë shtesë-super ekspertizë që të elaborohen dhe saktësohet lëndimet e marra tek i dëmtuari D.SH.,

Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë, av. Edona Sina konsiderojë se në këtë procedurë është e nevojshme që të konstatohet saktë se a ka pasur apo jo thyerje të ashtit të hundës e që sipas ekspertit që dëgjuam sot i njëjti tha që këtë fakt mund ta vërtetojë radiologu në çfarëdo periudhe që është e nevojshme. Andaj për ne mbetet vetëm ky fakt i rëndësishëm për tu vërtetuar, andaj unë si mbrojtje propozojë që të bëhet një ekspertizë nga radiologu e jo nga mjekësia ligjore, sepse nëse bëjmë super ekspertizë nga e njëjta fazë rezultati do të jetë i njëjtë, pasi që do të bazohet në dokumentacionin e njëjtën sikur ekspertiza e parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë, av.Egzon Doli, ka deklaruar se për të mos përsëritur kolegët parafolës theksojë se ekspertiza ligjore e dorëzuar lidhur me këtë çështje nuk është përputhje imperative ligjore të KPPK-së neni 138, meqenëse siç e konfirmojë eksperti mjeko ligjor që u dëgjua sot në të nuk ka fotografi-rogen ndërsa bashkëngjitja e të njëjtave është obligative në bazë të këtij neni dhe siç e potencojë edhe vet eksperti personat e thirrur për këtë çështje janë radiologu dhe otorinolaringologu, me qëllim të vërtetimit të faktit se a kemi pasur apo jo thyerje të kockave të hundës tek i dëmtuari D...propozojë caktimin e ekspertit të radiologjisë si dhe ekspertit nga fusha e ORL-së.

Gjykata lidhur me propozimin e av.Mone Syle ka marr vendim që ta Refuzoj propozimin e mbrojtëses së të akuzuarit të parë, av. Mone Syla që të caktohet super ekspertizë lidhur me dëmtimet e të dëmtuarit D.SH., pasi që fillimisht nuk kemi ekspertizë kundërthënëse lidhur me konstatimet e dhëna nga eksperti mjeko ligjor Dr. F.B., dhe për gjykatën ky fakte është sqaruar mjaftueshëm.

Gjykata lidhur me propozimin e av.Edona Sina ka marr vendim që Refuzohet propozimi i mbrojtëses së të akuzuarit të dytë, av. Edona Sina që të caktohet eksperti i radiologjisë për të konstatuar lëndimet e të dëmtuarit D. SH. si i pabazuar, pasi që fillimisht është dëgjuar eksperti i radiologjisë Dr.B.J., ku ka cekur konstatimet e dhëna në raport, ndërsa i njëjti nuk është ekspert i mjekësisë ligjore dhe nuk është kompetent për të konstatuar lëndimet e të dëmtuarit.

Gjykata lidhur me propozimin e av.Egzon Doli, ka marr vendim që Refuzohet propozimi i mbrojtësit të akuzuarit të tretë, av. Egzon Doli ku është propozuar që të caktohet eksperti i radiologjisë dhe eksperti nga fusha e ORL-së, pasi që fillimisht është dëgjuar eksperti i ORL-së Dr.I.E., i cili ka trajtuar rastin në fjalë dhe ka sqaruar për gjykatës se së është trajtuar pacienti dhe konstatimet sipas tij po ashtu edhe është dëgjuar eksperti i radiologjisë Dr.B.J., ku ka cekur konstatimet e dhëna në raport, ndërsa Gjykata ka vlerësuar se të njëjtit nuk janë ekspert të mjekësisë ligjore dhe nuk janë kompetent për të konstatuar lëndimet e të dëmtuarit, pasi që sipas legjislacionit në fuqi këtë e bënë Instituti i Mjekësisë Ligjore i cili është institucion legjitim i cili përbëhet nga ekspertët përkatës siç është eksperti Dr. F.B., i cili ka dhënë mendim dhe konstatim lidhur me dëmtimet –lëndimet e këtu të dëmtuarit D.SH., dhe i njëjti në mënyrë shumë të hollësisht dhe profesionale i sqarojë edhe në këtë shqyrtim gjyqësor.

## 2.5 Provat materiale

2.5.1 Nga leximi i Raportit fillestar të incidentit të Policisë së Kosovës, me numër të rastit 2020-EA-788 të datës 15.07.2020, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore të ndërmarr nga Policia e Kosovës. Lidhur me kohën e rastin dt.15.07.2020 ora e raportimit 09:30 min, vendi - adresa Gjakovë rr. “S...”, të dyshuarit dhe viktimat.

2.5.2 Nga Raporti i oficerit policor V.V., të datës 15.07.2020 ku është cekur se me ditën e incidentit gjersa isha me kolegët A.H., dhe H.M., nga disa qytetar jemi informuar se tek Restoranti ....., disa persona janë duke i sulmuar policët. Kemi shkuar në vendin e ngjarjes ku aty hasem kolegët duke u munduar dy të dyshuarve të iu vendosin prangat edhe pse të njëjtit ishin duke rezistuar policëve. Policët e njësive të biçikletave i kemi vërejtur të gjakosur në fytyrë dhe në këmisha. Në brendësi të terasës së restorantit në fjalë kam vërejtur një person i cili kishte bluzën me gjak dhe kishte në dorë një gotë, në atë moment që e kam vërejtur që ka bluzën me gjak e kam pyetur se “a ishit edhe ju të përfshirë në këtë rast”, i njëjti me gotë në dorë filloj duke mu afruar dhe në atë çaste menjëherë ia kam kapur dorën dhe ia kam vendosur prangat dhe koleget e kanë shoqëruar në Stacionin Policor.

2.5.3 Nga Raporti i oficerit policor J.O., të datës 15.07.2020, është konstatuar se me dt.15.07.2020 rreth orës 09:30 deri sa kam qenë në rr. “Skënderbeu” se bashku me R.M.,afër Stacionit kam vërejtur se tek Restoranti ....., dy zyrtar policor nga Njësia e Biçikletave janë sulmuar nga disa persona pastaj kemi vrapuar dhe me të mbërritur në vendngjarje unë së bashku me z.p A.T. kemi kapur njërin nga të dyshuarit dhe e kemi arrestuar, në atë moment kanë ardhur edhe disa zyrtar tjerë policor në asistencë dhe janë arrestuar të tre personat të cilët janë sjell ne Stacionin Policor.

2.5.4 Nga Raportit i oficerit policor HM., të datës 15.07.2020, është konstatuar se me datën 15.07.2020 rreth orës 09:20 minuta ishim në patrullim në këmbë tek dyert e Stacionit Policor në Gjakovë dhe kemi pranuar një informatë nga një qytetare se disa policë janë rrahur nga disa qytetar tek Restoranti ....” në rrugën “... kemi shkuar në vendin e ngjarjes fillimisht kemi vërejtur se një qytetar ishte duke bërë rezistencë aktive policit A.T., dhe në ato momente që të dy rrëzohen në tokë, unë i kam ndihmuar menjëherë kolegut duke e futur nën kontroll qytetarin e dyshuar, pasi i ka vënë prangat njëri nga kolegët, kur jam ngritur në këmbë e kam vërejtur kolegun tjetër D.SH., i cili kishte qenë tërësisht i gjakosur në pjesën e përparme të fytyrës dhe i njëjti na ka treguar gojarisht se edhe një palë tjetër ishte i dyshuar i cili ishte duke qëndruar në taras te pjesa e jashtme e restorantit, ku kam vazhduar në atë drejtim dhe i kemi dhënë urdhrin verbal që të mos rezistojë dhe pasi është vënë nën kontroll të njëjti ia ka vendosur prangat kolegja V.V.,

2.5.5 Nga Raportit i oficerit policor E.K., të datës 15.07.2020, është konstatuar se m datën 15.07.2020 rreth orës 09:20 minuta patrulla jonë e përbërë nga unë, dhe kolegu A.L., gjersa ishim duke patrulluar në këmbë në Rrugën “.....” kemi parë kolegët H.M., A.h., dhe V.V. duke vrapuar në drejtim të restorantit “... ku kemi vrapuar pas tyre dhe hasëm kolegët D.sH., dhe A.T., të përgjakur të cilët mundoheshin të neutralizonin personat e dyshuar nga të cilët ishin sulmuar, jam afruar tek personi i cili bënte rezistencë aktive kolegut D.. dhe rreshterit A..., i njëjti pasi nuk zbatonte urdhrat verbale dhe krijonte rezistencë aktive për futjen nën kontroll si dhe duke u bazuar në situatën siç ishte duke pasur parasysh dy kolegët e gjakosur kam përdorur sprejin aq sa është e nevojshme për ta futur nën kontroll ty dyshuarin ku dhe më pas ia kam vënë prangat.

2.5.6 Raporti i hetuesit policor P.P. të datës 15.07.2020, lidhur me rastin 2020-EA-788, ku janë konstatuar veprimet hetimore në vendin e ngjarjes si rrethimi i vendit të ngjarjes, hetuesit të cilët kanë marrë pjesë si dhe krim teknika po ashtu është konstatuar se në vendin e ngjarjes ka dalur edhe prokurori i shtetit dhe nga vendi i ngjarjes jemi larguar në orën 10:40 minuta.

2.5.7 Nga Raporti i oficerit policor J.O., të datës 15.07.2020, konstatohet se me datën 15.07.2020 rreth orës 09:30 minuta patrulla policore ishte sulmuar nga 3 persona duke iu shkaktuar lëndime të rënda trupore, rasti ka ndodhur deri sa policët po i shqiptonin një gjobë një personi tjetër dhe

në atë moment ka ndërhyrë i dyshuari N..., pastaj të njëjtit i vijën në ndihmë edhe dy të dyshuarit tjerë të cilët shkojnë prapa duke e kapur nga pas policin D.SH., të cilin e tërheqin dhe e rrëzojnë në tokë, pasi e rrëzojnë D., të njëjtin e shkelmojnë në fytyrë duke i shkaktuar frakturë në hundë dhe gjakderdhje. Polici A.T., kthehet që ti ofrojë ndihmë policit D., ku edhe ky sulmohet nga të dyshuar. Në vendin e ngjarjes janë arrestuar tre të dyshuarit dhe është konfiskuar vetura e tipit . . . pronë e të dyshuarit B.H.. Në vendin e ngjarjes janë vërejtur njolla të kuqe gjaku gjithandej, gjithashtu në vendin e ngjarjes ka ardhur ndihma e parë e cila ka dhënë ndihmën e parë policëve të lënduar dhe të njëjtit i ka dërguar në spital, ku zyrtari policor D.SH., është hospitalizuar kurse zyrtari policor . A.T., pas tretmanit mjekësor është liruar nga mjekët.

2.5.8 Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve të datës 15.07.2020, konstatohet se është bërë sekuestrimi i thikës nga personi N.H., nga zyrtari policor M.G.,.

2.5.9 Nga Mendimi i ekspertit mjeko- ligjor Dr. F.B., të datës 20.07.2020, është konstatuar se tek i dëmtuari D.SH., në bazë të raporteve mjekësore, në shkresat e lëndës ka konstatuar se tek i dëmtuari dëmtimet e përshkruara në gjetje-konstatim paraqesin: - Thyerje të kockave të hundës, plagë shqyese në hundë, ndrydhje të indeve të buta të qafës, parakrahut të djathë, të dy gjunjëve me gërvishtje në gjurin e djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. – Operacioni : repunim manual dhe instrumental.-Këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtimin e përkohshëm të shëndetit. Ndërsa tek i dëmtuari A.T., në bazë të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës është konstatuar se: Dëmtimet e përshkruara në gjetje-konstatim, paraqesin:-ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të majtë dhe bërrylit të dorës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore.-Këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

2.5.10 Nga Raporti i vendit të ngjarjes të përpiluar nga policia e Kosovës si dhe foto albumi lidhur me vendin e ngjarjes, është konstatuar se Njësia e forenzikës me tu informuar me rastin me datën 15.07.2020 ka dal në vendin e ngjarjes në orën 09:38 minuta. Vendi i ngjarjes ishte parkingu para “...” ku kemi vërejtur veturën Ford me ngjyrë të kaltër e parkuar në parking shumë afër rrugës kryesore, në tokë vëreheshin pika të kuqe të dyshuara gjak.-Vendi i ngjarjes rruga “...” , konkretisht në parkingun e restorantit “...”, ambient i hapur skaj rrugës kryesore dhe toka ishte e shtruar me kubëza prej betoni, po ashtu është konstatuar veprimet hetimore të cilat i ka ndërmarrë krim teknika dhe gjetjet në vendin e ngjarjes të përshkruar në këtë raport si dhe fotografimi i vendit të ngjarjes së bashku me skicën dhe fotoalbumin.

2.5.11 Nga shikimi i 25 fotove në formatin A4 nga fotoalbumi të përpiluara nga krim Teknika e Policisë së Kosovës, në foton nr.1 shihen lëndimet e të dëmtuarit D.SH., i cili ka lëndime në hundë dhe uniformen – bluzën mi pika të gjakut. Foto nr.2 pjese e gjurit e mavijosur, foto nr.3 pjesë e mavijosur mbi gjurë dhe e ënjtura në anën e djathtë, foto nr.4 i dëmtuari D... në profil përball shihen lëndime në hundë e cila është fashuar, syrin e majtë të mavijosur, duart me njolla gjaku dhe uniformë – bluzën me njolla gjaku, foto nr.5 i dëmtuari në profil nga mbrapa në anën e djathtë nën sqetull njolle e madhe e gjakut, foto nr.6 i dëmtuari D.... në profil në të djathtë shihet hunda e fashuar e përshkruar si më lartë dhe në anën e djathtë gjak nën sqetull dhe mbi krahë, foto nr.7 i dëmtuari D... nga afër duke rikuperuar hundën dhe njolla gjaku në bluzë të përshkruara si më lartë, foto nr.8 i dëmtuari gërvishtje nën gju dhe mbi gju të majtë, foto nr.9 gërvishtje në nën gjurin e djathtë dhe të majtë mbi gjurin, foto nr.10 i dëmtuari i shtrirë në spital ku shihet i njëjti i gjakosur në dy duart dhe njolla gjaku në uniformë, foto nr.11 i dëmtuari i shtrirë i fotografuar nga afër ku shihet hunda e fashuar dhe uniforma me njolla gjaku, foto nr.12 i dëmtuari D...ku shihet hunda e me vragë dhe e jonizuar, foto nr.13 dora e të dëmtuarit me njolla gjaku, foto nr.14 i dëmtuari A.T., ku shihet syri i majtë i mavijosur dhe uniforma – bluza të

shqyer, foto nr.15 i dëmtuari A. në profil të përshkuar si më lartë, nr.16 shihet një mavijosje në anën e majte mbi faqe dhe veshi i mavijosur, foto nr.17 të lartcekurat e përshkuar si në foton paraprake dhe uniforma e shqyer foto nr.18 i dëmtuari A... në profil në anën e djathtë ku shihet uniforma e grisur nën sjetull njolla gjako dhe mbi kyçin e dorës gërvishtje, foto nr.19 gërvishtje mbi kyçin e dorës se djathtë, foto nr.20 i dëmtuari A... në profil përball uniforma e grisur syri i majtë dhe i djathtë i mavijosur, foto nr.21 i dëmtuari A. uniforma e grisur, foto nr.22 i dëmtuari A... në Spital ku shihet uniforma e grisur, foto nr.23 i dëmtuari A... në profil nga para uniforma e zhytur në të majtë në dorë e grisur në të djathtë nën sjetull me njolla gjaku, foto nr.24 i dëmtuari A... ku shihet uniforma e grisur si dhe dora e djathtë e mavijosur, foto nr.25 i dëmtuari A...shihet dora e djathtë e mavijosur, uniforma e grisur dhe syri i majtë i mavijosur (këto janë foto me ngjyra të cilat janë sjell nga krim teknika në lëndën e procedurës paraprake e cila lëndë iu është bashkangjitur lëndës kryesore, ndërsa foto në lëndën kryesore nga organi akuzës janë në fotokopje).

2.5.12 Nga Video incizimi i vendin e ngjarjes të marr nga kamera si provë pranë vendit të ngjarjes i cili ka ndodhur para Restorantin .... në Gjakovë rr. “.....” ku shihet se njësia e biçikletave e përbëre nga zyrtarët policor D.Sh., dhe A.T., gjatë patrullimit ndalen tek vendi i ngjarjes pasi që dy automjete ishin të parkuara në mënyrë të pa rregullt dhe atë . . . X5 e dëshmitarit B.B., njëherë pronar i Restorantit “....” dhe veturën . . . e kaltër e dëshmitarit B.Q., ku nga pronarët kërkohen dokumentet në mënyrë që të iu shqiptohet tiketa ku siç shihet B.Q., (me këmishë të kuqe) bisedon me zyrtarin policor, pastaj del i akuzuari N... për të biseduar me zyrtarët policor (biseda e tyre nuk dëgjohet në video incizim) gjatë kësaj bisede sipas këtij incizimi shihet njëra nga të akuzuarit B... apo Sh... (të dytë të veshur me të rroba të bardha me mongë të shkurta si pantallonat si bluzat) njëherë është afruar tek vendi ku është biseduar pastaj është larguar prapë tek tavolina. Deri sa është zhvilluar biseda dëshmitari B.Q., shihet duke biseduar në telefon pas automjetit të tij, pastaj pas automjetit nga ana e video incizimit shihet duke biseduar i akuzuari N.. me zyrtarët policor (nga ky këndë nuk shihen veprimet dhe biseda e zhvilluar në mes të N... dhe zyrtarëve policor), mirëpo tutje shihet se dëshmitari B.Q.,pastaj ishte afër tyre rreth një metër përball tyre, ku shihen zyrtarët policor duke vepruar ku ky nga prapa e prek me dorë pra ka qenë afër, po ashtu në hyrje të tarasës së lokalit shihet po ashtu dëshmitari B.B. i cili largohet nga vendi i ngjarjes ndërsa punëtori – kamerieri gjatë gjithë kohët qëndron aty përballë vendit ku ishte duke u zhvilluar biseda. Kur është tentuar për me arrestuar të akuzuarin N., shihen të akuzuarit Sh... dhe B... duke vrapuar dhe pa biseduar fare sulmojnë zyrtarët policor ku B. nga prapa e kap për qafe duke e shtrënguar të dëmtuarin D... duke e tërhequr nga pjesa e përparme e automjetit të dëshmitarit B... shtyhen afërisht tri metra tek hyrja e terasës ku rrëzohen pasi që B... e tërheq nga prapa, ku i akuzuari B... e kap për qafe dhe nuk e lëshon, ndërsa i akuzuari Sh... e godet me shkelm në fytyrë të dëmtuarin D....i cili ishte i rrëzuar në tokë më të akuzuarin B..., pastaj i dëmtuari A... i shkon në ndihmë për ta tërhequr të akuzuarin Sh... ku i njëjti e rrëzon të dëmtuarin A.. të cilin e godet duke qëndruar mbi të, ku i dëmtuari A... lirohet duke u përleshur ku i dëmtuari A. e nxjerr sprejin dhe ia lëshon të akuzuarit B... dhe shkon për ta ndihmuar kolegun D... i cili ishte në tokë, ndërsa i akuzuari Sh... fillimisht bisedon diçka me N...., pastaj shkon tek i dëmtuari D... dhe e shkelmon me shkelm në fytyrë të cilin ishin afër rreth dy metra, pastaj prapë i godet të dëmtuarit të cilit ishin në tokë dhe pastaj vijnë përforsimet policore ku prapë njëri nga të akuzuarve bën rezistencë ku i njëjti neutralizohen tek automjeti i dëshmitarit B. dhe arrestohet, ndërsa i akuzuari tjetër reziston brenda terasës derisa edhe aje arrestohet.

2.5.13. Nga dosja mjekësore e të dëmtuarit D.SH., respektivisht nga Fletë lëshimit me epikrizë me nr.87 leshur nga SR ”Isa Grezda” në Gjakovë i datës 15-20.07.2020 nga Reparti i ORL-së, janë konstatuar lëndimet, ku pacienti pranohet pas një aksidenti – rrahje. Në RTG ossis nasi: Fractura ossis nasi (Dr.B.J.). Pas pranimit bëhet operacioni i lartshënuar nga Dr.I.E., Po ashtu

në këtë dosje gjendet lista e amzës ku janë shënuar diagnoza e pranimit dhe lëshimit. Po ashtu konstatimi i datës 16.07.2020 i përpiluar me dorëshkrim nga Dr. B.J., pas shikimit të RNG, analizat për të dëmtuarin së bashku me raportin kthyes nga diagnostika, si dhe fletë lëshimi i Repartit të emergjencës me nr. prot 9277, i datës 15.07.2020 në emër të dëmtuarit D.SH., i cili është pranuar në emergjencë me dt.15.07.2020.

## 2.6 Mbrojtja e të akuzuarve

**2.6.1 I akuzuari B.H.**, gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtën e tij ka deklaruar se unë nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohem duke deklaruar se ditën kritike rreth orës 09:00/h të mëngjesit ishim tek “...” duke pirë kafe, kam qenë me vëllain N... dhe djalin e axhës Sh.i, më vonë ka ardhur edhe B.Q., Nga tavolina i parë është quar N...ndërsa unë kam shkuar pas 3 apo 4 minutave. Ka shtuar se kur është dal N... me iu kërkuar falje, i njëjti ka qenë duke biseduar por nuk e di se çka, pasi që kanë qenë më larg, ka qenë duke shkruar diçka D..., pasi e ka kryer atë e kanë kapur vëllain për duarsh dhe për fyti, vëllai është i sëmurë dhe duke e parë dhe ditur gjendjen e tij në atë moment nuk kemi ditur as vet si me reaguuar ndrysh përpos me e tërhequr prej tij. Unë e kam kapur D... me e tërhjek prej vëllait, jam rrëzuar me gjithë te në krahun e djathtë, e kom mbajtur qashtu një kohë disa sekonda, mu ka afruar N... rreth 3-4 metra dhe më ka bërtit liroje, unë e kam liruar D...pasi është ngritur në këmbë D... na ka qitur sprej mu të parit edhe vëllai si më ka thënë ai, se më nuk e kam parë, pastaj kam hy brenda në terasë të lokalit, kam lyp ujë për me i larë sytë, janë ardh forca tjera të policisë na kanë arrestuar aty dhe na kanë shoqëruar për në stacion. Gjatë përlëshjes nuk e ka goditur D.... Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Feride Xani ka pyet se në momentin kur jeni ngritur nga tavolina me kënd keni qenë. I akuzuari ka deklaruar me Sh.in, veprimet e Sh.it fillimisht e kom pa se e ka kapur A.n në dorë dhe ia ka vu dorën në krah duke e tërhekur prej N..., pastaj nuk e kom par Sh.in. Av.Feride Xani ka pyet a ka qenë Sh.i afër të dëmtuarit D...? I akuzuari jo nuk e kam parë. Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë Av.Prek Kola ka pyet se a ju kujtohet kur keni shkuar te vendi aty a e keni parë N....duke e shtyrë apo goditur ndonjërin nga 2 policët? I akuzuari jo pasi që ka qenë i bllokuar, po ashtu edhe kur është liruar nuk i ka goditur apo shtyrë. Tek vendi i ngjarjes N.... çka ka vepruar nuk e kam dëgjuar por e di se është quar për ti kërkuar falje. Kur ka filluar përlëshja N.... ka qenë i pshtetur për kerr, kur e kanë kap me e arrestuar, shton se pasi që jam rrëzuar unë me të dëmtuarin D... më ka bërtitur lësho. Prokurori ka pyet se ju deklaruar se së bashku me Sh... jeni shkuar për ta tërhequr N..., pasi policia e kanë kapur për fyti, unë po ju pyes kur shkuat aty ju a tërhoqët N... apo zyrtarët policor? I akuzuari, unë e kam kapur D..., e kam tërhjekur nga veti dhe jam rrëzuar me gjithë te. Unë e kam kapur për fyti dhe i pari ka rënë D..., dhe unë jam ra në krahë pas tij, dikund 15-20 sekonda. Kur kanë ardhur përforcimet policore kemi qenë në këmbë të dytë. Ndërsa nuk e kam parë Sh... ku ka qenë, ndërsa N... ka qenë diku rreth 3 apo 4 metra. Unë kur e kam tërhequr D... dhe jam rrëzuar nuk kam parë më, përpos N... i cili ka qenë 3-4 metra dhe më ka bërtitur liro. Prokurori ka pyet se në procesverbalin ku jeni pyetur nga ana e prokurorit, faqja 4 pasuesi i fundit, keni deklaruar se i pranojë veprimet që i kam bërë dhe shprehi keqardhje për rastin e ndodhur, gjithçka ka ndodhur spontanisht, qëllimi nuk ka qenë ta lëndojë, por kam qenë i shqetësuar për gjendjen e N...A mbeteni pranë këtij deklarimi? I akuzuari ka deklaruar se lidhur me pyetjen e parashtruar nga prokurori i shtetit deklaroi se jam ndier i turpëruar dhe gjithçka ka ndodhur në afekt. Prej D.... është përdorur spreji rreth 15 sekonda para se me ardhur përforcimet tjera. I dëmtuari D.SH., ka pyet të akuzuarin a kam qenë ballë për ballë kur më kapur, apo keni vepruar prapa shpinës. I akuzuari ke qenë në krah prej meje. I dëmtuari D.SH., ka pyet pozita që kam ra në tokë a më ke ngre, shtyrë apo si? I akuzuari, unë të kam tërhequr prej vetit dhe ti ke rënë i pari dhe unë kam rënë pas teje në krah. Në cilën pozitë kam rënë? I akuzuari në pjesën e djathtë në fytyrë. I dëmtuari ka pyet se nëse ka qenë qëllim tërheqja prej N..., pse nuk jam lëruar menjëherë kur është liruar N....? I akuzuari ka deklaruar pasi që i dëmtuari ka tentuar me e nxjerrë revolen, dhe

e kam penguar. E kam mbajtur për fyti, diku 15 -20 sekonda, nuk e kam dëgjuar se çka ka biseduar N... me policët, kemi vepruar menjëherë pa i pyetur se për çka e kanë pshtetur N.... për automjeti mirëpo paraparakisht e kemi ditur se N....ka shkuar për ti kërkuar falje për automjet. Automjeti të cilit ia kanë shqiptuar tiketën ka qenë i B....Në rigjykim i njëjti ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklarimeve të mëparshme. Siç kam deklaruar më herët për shkak tensionimit të situatës që ka ndodhur, bisedat nuk i kam dëgjuar se kam qenë larg, unë kam pritur një kërkim falje që ka qenë dashur me u ba, por nuk ka zgjatur shumë dhe kur e kanë kapur vëllain për fyti dhe për duarsh unë kam reaguuar i pari për shkak të gjendjes shëndetësore të vëllait (me stenda, sheqer, moshë), nuk kemi pasur ndonjë qëllim për dëmtim të asnjërës palë, vetëm e kam bllokuar e kam kapur për fyti dhe e kam tërhekur, ku gjatë lëvizjeve që i kemi bërë pa ndonjë qëllim të caktuar, jam rrëzuar unë me të dëmtuarin D... dhe aty kemi mujt me u lënduar unë edhe ai, ku unë kam qenë i lënduar në bërryl, ky u ra më shumë me fytyrë në tokë dhe aty ka mundur me u lënduar pasi që ka qenë terren i vrazhdë. Lëndimet i kemi marr edhe në Stacionin policor, ku edhe kemi paraqitur rastin në Inspektorat. Nuk e kam njohur zyrtarin policor, nuk e kam goditur, vetëm e kam mbajtur për qafe për shkak të armës dhe nuk ka pasur qëllim me e goditur. E kam kapur për fyti nga mbrapa me dorën e majtë, pasi që ne kemi qenë prapa, përball ka qenë vëllai N....dhe A...-zyrtar policor. Nuk kam pasur qysh me i dal përpara se këta të dytë e kanë kapur vëllain, ku A... zyrtari policor e ka kapur për fyti, ndërsa D.... për dore, ndërsa pastaj e kam kuptuar se tek N... e ka mbi sy të qarë por nuk e kam parë se kush e ka goditur. Qëndrimi i rrëzuar në tokë ka qenë punë sekondash 40 sekonda mund të jenë. Personat e dëmtuar e kam ditur që janë zyrtar policor, kanë pasur uniformën e Policisë së Kosovës atë ditë të veshur. Ne kemi qenë duke pirë kafe me Sh...., ndërsa sa është zhvilluar ngjarja unë nuk e kam parë veprimet e Sh.it pasi që ka qenë në anën e kundërt timen. Pozita ime ka qenë me fytyrë nga restoranti ndërsa Sh.i ka qenë mbrapa shpinës time por nuk e di pozicionin. Unë kam dal i pari ndërsa nuk e di nuk kam qenë i fokusuar kur ka dal Sh..... E kam liruar vet të dëmtuarin D..... Nuk është përdorur prej gjatë përlëshjes por kur kanë ardhur zyrtarët tjerë kanë përdorur prej.

**2.6.2 I akuzuari Sh.H.,** gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtën e tij ka deklaruar se unë nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohem duke deklaruar se me datën 15.07.2020 rreth orës 09:00/h, kemi qenë unë, N... dhe B...., kemi shkuar në lokal, kemi porositur kafe, dhe ndejtur disa kohë aty pastaj aty ka ardhur B.Q., ku kemi ndejtur aty me te, e pamë që erdhën 2 polic, e thirrën B... që e ka parkuar kerrin keq, pastaj u qu B... ka shku me fol me ta, dhe ka fol me .... dhe kanë biseduar në mes vete, pastaj ka dal shefi i lokalit B.... edhe kanë biseduar njëherë, pastaj ka shkuar N...., ku na tha po shkojë po e lus se mos po e fal B...., edhe i kemi pa duke biseduar ndërmjet veti, atëherë e kom pa që e ka shty N... dhe e ka goditur me boks në gjoks D....pastaj e kom pa duke ia dredhuar dorën edhe unë me B... jemi ngritur në këmbë, kur kam shkuar aty e kom pa A.n duke shkuar nga N.... edhe e kom kap në krah dhe kam ngrehë prej vetit dhe e kam shtyrë, qëllimi jam u kon me e da me e largu se për shkak se N... ka probleme shëndetësore, dhe jam frigu se po mbet aty kur e pash mendova se po rrëzohet për toke, unë kam filluar e kam shty A..., i cili ka marrë në thu përmbas, edhe është rrëzuar A.... duke u rrëzuar i njëjti më ka kapur dhe unë kam rënë mbi te, kam tentuar për me u largu më ka kap për duar, kam qenë në afekte ndoshta edhe e kam goditur, pastaj është qu A....edhe e ka nxjerrë sprejin duke më hedhur sprej, në ato momente unë nuk kam parë asgjë, pastaj janë ardh policia dhe më kanë arrestuar, ku unë iu kam thënë se nuk jam ka shoh asgjë. Nuk kam qenë afër tek D..., distanca mes D.... dhe A.... ka qenë afër, pastaj unë e kam tërhequr A... dhe kam filluar me e shty, pastaj A. është rrëzuar, shton se unë D.... nuk e kam parë, pasi që kam qenë në një pjesë tjetër, dhe nuk mund ta përshkruajë distancën. Përafërsisht duhet të jetë 10 metra kur kemi rënë në tokë. Nuk kam pasur kontakt me D..... Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë av.Prek Kola ka pyet se para se me shku ju tek rasti a e keni parë se N...e ka goditur apo shtyrë ndonjërin prej zyrtarëve policor? I akuzuari ka deklaruar se jo, unë vetëm e kom par A.n duke

shkuar në drejtim të tij dhe pastaj nuk e di se çka ka ndodhur vetëm e kam tërhequr. Av.Prek Kola, kur ju deklaruar se e keni tërhequr A..., N... a ka ndërmarre ndonjë veprim, a e ka shtyrë apo goditur ndonjërin polic? I akuzuari ka deklaruar se jo. Prokurori ka pyet se ju thatë se pasi ia kanë dëdhur dorën N... ju jeni qu së bashku me B..., a e njoftuat për gjendjen shëndetësore të N...? I akuzuari ka deklaruar se unë nuk e kom njoftuar, pasi që e kam parë A,... duke shkuar në drejtim të N... dhe e kam tërhequr, pra unë nuk e kam njoftuar. Prokurori ka pyet se ju deklaruat se kur keni shkuar e keni tërhequr A.... dhe jeni rrëzuar, a e ke vërejtur se a ka pasur lëndime A... apo ti? I akuzuari ka deklaruar se për A... nuk e kam parë ndërsa për vete jo nuk kom pas. Prokurori ka pyet se kur jeni arrestuar nga ana e policisë në rrobat e juaj janë gjetur njolla gjaku, a të kujtohet të kujt kanë qenë ato rroba? I akuzuari ka deklaruar se nuk di se të kujt janë. N... nuk e kam parë, nuk ka qenë afër neve. Prokurori ka pyet se ju në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 14.08.2020 në faqen 4-rë, në pyetjen e avokatit të juaj Azem Islamaj. Se a e keni shtyrë vetëm policin A..., a keni pasur kontakt tjetër me D...? Ju jeni përgjigjur : Jo nëse jemi afruar afër mos e kam prek. Ndërsa sot po deklaron se nuk keni qenë afër, Cila është e vërteta? I akuzuari ka theksuar se këtë që e deklarova sot, pasi që nuk kam qenë afër duke shtuar se vetëm në fillim kam qenë afër. A. e ka përdorur sprejin, kur është përdorur spreji menjëherë më kanë arrestuar policia. I dëmtuari D.SH., ka pyet se cili keni ardhur në vendin e ngjarjes i pari, ti apo B...? I akuzuari mendojë se duhet të jetë B... Gjykata ka pyet se sipas akuzës ju akuzoheni se kur i akuzuari B... ka qenë në tokë me të dëmtuarin D... ju e keni goditur me shkëlq në fytyrë. A është e vërtetë kjo? I akuzuari nuk është e vërtetë. I akuzuari Sh. ka shtuar se palës së dëmtuar A.... i kërkojë falje pasi që nuk kam pasur për qëllim të keq, i kërkojë falje atij dhe familjes së tij. Në rigjykim i akuzuari SH.H., ka deklaruar se ditën kritike kemi qenë duke pirë kafe unë, N..., B....dhe B.Q., ne kemi qenë duke shkuar në punë dhe kanë ardhur policët dhe B.Q., e kishte parkuar veturën keq, dhe B... u qu dhe ka folur me policët, atëherë N...tha se po shkojë po i lutna se mos po e falin, dhe kanë folur ndër vete, ne nuk i kemi dëgjuar pasi që kanë qenë bukur larg, ku pastaj e kemi parë që N... ia kanë dëdhur duart dhe e kanë lëshuar me kokë në haubë të kerrit, dhe unë e B...jemi qu me iu tregu policëve se është me probleme shëndetësore, po nuk i kanë dhënë afat N... dhe unë jam munduar me e tërheq A..., ku mandej unë jam munduar krejt kohën me e shty A.n dhe nuk e di se pse po më akuzon D..., atë ditë kom pas panik-jam frikësuar se A... po e nxjerrë revolen dhe ndoshta kam bërë ndonjë veprim pasi që kam qenë në afekt dhe nuk kam mundur me i kontrolluar veprimet ndërsa për të dëmtuarin D. nuk jam në dijeni se çka i ka ndodhur. Unë kam qenë tek A. dhe kemi vazhduar deri në trotuare. Nuk e kam vërejtur se ku ka qenë D.... A. e ka nxjerr sprejin dhe ma ka gjuajtur dhe pastaj kanë ardhur policët tjerë dhe unë kam rënë për tokë. Saktësisht nuk muj me ditë se nuk e kam parë vetëm e di se ja kanë dëdhur duart dhe e kanë lëshuar në aubë të xhipit dhe unë A.n e kam tërhek. A. ka qenë afër N...duke e arrestuar. Nuk e di çka ka vepruar D,,,,, pasi që unë vetëm me A.n jam ballafaquar. N... nuk ka vepruar asgjë në atë moment dhe nuk e kam parë mandej, nuk e kam parë që N... e ka goditur ndonjërin të dëmtuar. Gjykata e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm keni deklaruar se “E kam parë D... duke ia dëdhur dorën N...” ndërsa sot në pyetjen e prokurores deklaruar se “E kam parë AA.,rbenin”, cila është e vërteta? I akuzuari nuk po më kujtohet. A... ka gjuajtur në drejtim tim me sprej dhe kam tentuar me e ndal apet.

**2.6.3 I akuzuari N.H.**, gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtën e tij ka deklaruar se unë nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohem duke deklaruar se me dt.15.07.2020 kam qenë në “... së bashku me vëllain tim B...dhe djalin e axhës Sh.. duke pirë kafe, mandej e kam ftuar B.Q., për kafe pasi që kam pasur nevojë për një shofer, ka ardhur B... kemi biseduar e pirë kafe, dhe ai ke gati për tu quar, kanë ardhur 2 polic dhe janë afruar tek kerri i B..., B... është qu i pari dhe ka shkuar te policia, pastaj kur e kom vërejtur se e kanë në plan me i dënuar, jam qu dhe kam shkuar iu kam kërkuar falje, dhe iu thash se a ka



mundësi me e fal, se e thirra unë për kafe, herën e parë D., nuk është përgjigjur, e kom lut prapë, herën e dytë më ka thënë: mshele gojën se nuk ki maskë, iu kom lut prapë në emër të djalit E., se janë në fakultet bashkë, më ka thënë ta bëjë dënimin për maskë, pastaj unë i thashë bone, për herën e tretë më ka thënë apet: ta bëjë apët dënimin, unë i thash: tjetër gjë nuk ka çka mu bo, bone dënimin, më tha: të lidhi të ngrejë zhagë nëpër krejt Gjakovën, pastaj më tha je i arrestuar, unë iu drejtova: unë nuk të kam bërë gjë për me më lidh, unë jam mbështetur për automjetin B.Q., në pjesën e përparme, ky ka pritur deri sa e ka shkruar tiketën, si e ka shkruar tiketën, dhe ka ardhur më ka kap për dorë dhe për fyti dhe më ka dredhur për haub të kerrit, pastaj dul B., duke pasur parasysht gjendjen time shëndetësore pasi që vuaj prej zemrës, sheqerit etj, e ka kap D... për me e largu, dhe janë kacafytur dhe që të dy janë rrëzuar për toke, pastaj ka dal Sh...i dhe janë kacafytur me A.n. Unë iu kam bërtitur për me u nda. Nuk e kam goditur apo shtyrë A.... apo D..... Unë iu thashë se po qohem e po ju kërkojë falje, se mos po e falin pa e dënuar pasi që e thirrën vetë dhe B.... më tha dy herë mos u qo. Mbrojtësja e të akuzuarit të dytë av.Feride Xani ka pyet se a e keni parë të akuzuarin Sh... afër të dëmtuarit D...? I akuzuari nuk ka qenë afër. Prokurori ka pyet se a i keni parë B... dhe Sh... nga momenti kur janë ngritur nga lokali dhe kanë ardhur te vendi ku keni qenë ju? I akuzuari ka deklarua se po, distanca ka qenë afërsisht 10-12 metra, unë nuk i kam dëgjuar se kanë folur diçka, por janë kacafytur. Jo nuk kanë qenë afër të dytë, unë e kom pasur D... afër ndërsa A... duhet të ketë qenë 2-3 metra larg, unë nuk e di por kur e kam kthyer krytë e kam parë Sh.... me A...Unë kam qenë afër diku rreth 3-4 metra. D... më së pari e ka përdorur sprejin, pastaj e ka përdorur edhe A..... Lëndimin tek D... nuk e kam vërejtur se ka qenë moment i shprej, por në buzë ka pasur gjak. Sprejin e kanë përdorur ndaj meje e B... na ka qit D... A... ka qenë më larg kur ka gjuajtur sprej. Me, B... kam qenë 1 metër e 30 ndërsa me Sh... kemi qenë larg. Unë vetëm kam bërtitur largohi, e tjetër veprim nuk kam bërë. Avokati i të dëmtuarit B... ka pyet se gjatë arrestimit që ju ka bërë D... a ju ka goditur? I akuzuari ka deklaruar se nuk kam mujt me e vërejtur. Sipas zakonisht i kemi dërguar njerëzit për pajtim. I dëmtuari ka pyet se e të kemi kërkuar disa herë që të largoheni pasi që nuk keni qenë i përfshirë? I akuzuari me sa kam dëgjuar unë jo. Me sa kom ndi unë nuk mu është kërkuar dokumenti identifikues. Gjykata ka pyet se kur ka ndërhyrë B... pasi që ka parë duke u arrestuar apo kur? I akuzuari ke deklaruar se B. ka ndërhy kur ka filluar arrestimi, pasi që më ka shtrirë në haub të kerrit. Gjykata ka pyet se sipas deklarami të dëmtuarit A. i njëjti ka deklaruar se nga ana e juaj gjatë përleshjes është shtyrë me dorë A është e vërtetë? I akuzuari jo nuk është e vërtetë. Gjykata ka pyet se në deklaratën e dhënë në prokurori në faqen 4, në pyetjen e prokurorit se kur ju ka thënë policia se je i arrestuar , çka keni vepruar dhe a keni rezistuar? ju jeni përgjigjur: Më kanë kapur për dore, ia kam larguar dorën, pastaj ma kanë qitur sprejin dhe jam arrestuar nga njësitë tjetër. Pyetja është a të kanë arrestuar të dytë përnjëherë apo njëri ka qenë? I akuzuari ka deklaruar se vetëm D... e kom vërejtur, pasi që ka përfunduar përleshja. B... ka qenë aty duke u marrë me kerr të vetin, por ka qenë aty me siguri e ka pa rastin. I akuzuari N.H., në rigjykim ka deklaruar se pas konsultimeve me mbrojtësin tim do të shfrytëzojë të drejtën time dhe të mbrohem në heshtje.

### 3. Elementet e veprës penale

Në nenin 402 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar e kryen: *“Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare, në lidhje me detyrat zyrtare”* dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri ne tre (3) vjet. Në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar forma e cilësuar e kësaj veprë penale: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1 përfshin gjyqtarin, prokurorin, policin, zyrtarin doganor, zyrtarin korrektues, në lidhje me detyrat zyrtare, sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik”*. Po ashtu në ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar po ashtu forma e

cilësuar e kësaj vepre penale: “Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të gjyqtarit, prokurorit, policit, zyrtarit doganor, zyrtarit korrektues, ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”. Po ashtu në ndërsa në paragrafin 6 të këtij neni është përcaktuar po ashtu forma e cilësuar e kësaj vepre penale: “Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të gjyqtarit, prokurorit, policit, zyrtarit doganor, zyrtarit korrektues, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”.

#### 4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën konform nenit 361 parag 1 dhe 2 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike si vijon:

Të akuzuarit B..., Sh... dhe N.H., kanë qenë në restorantin . . ., duke pirë kafe me dëshmitarin B.Q., i cili kishte parkuar automjetin e tij në trotuar në mënyrë të pa rregullt, ku të dëmtuarit zyrtarët policor D.SH., dhe A.T., ishin në detyrë zyrtare dhe ishin duke i shqiptuar tiketën kundravjetëse dëshmitarit B.Q., i cili ishte pajtuar dhe iu kishte dhënë dokumentacionin zyrtarëve policor, ndërsa pastaj del i akuzuari ... fillimisht duke iu kërkuar zyrtarëve policor që të falin të njëjtën, ndërsa zyrtarët policor nuk kishin pranuar dhe i kishin thënë të akuzuarit N., që të vendos maskë (pandemia) dhe të largohet sepse nuk ishte palë, ku i njëjti kishte insistuar duke i lëshuar fjalë, pastaj zyrtari policor D.SH., kërkon nga i njëjti që të ia prezantoj letërnjoftimin i njëjti refuzon dhe pastaj zyrtarët policor e njoftojnë që është i arrestuar duke u munduar që ta prangosin, ku të akuzuarit B... dhe Sh... me vrap duke mos dëgjuar bisedën farë që zhvillohej vrapojnë nga lokali ku i akuzuari B... me dorë e kap të dëmtuarin D... për qafe dhe e ngreh prapa duke u rrëzuar së bashku me të, ndërsa i akuzuari Sh... e godet me shqelm në fytyrë, ku pastaj i dëmtuari A.. tenton që ta largoj nga i dëmtuari D... i njëjti e godet dhe e shtyn edhe të dëmtuarit A..., duke iu shkaktuar të dëmtuarit D... lëndime të rënda, ndërsa të dëmtuarit A.. lëndime të lehta trupore.

Lidhur me gjenden faktike në pikën I të këtij aktgjykimi, që ka të bëjë me veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk duhet të iu falet besimi mbrojtjes së të akuzuarve B... dhe SH.H., të dhënë gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore me të cilat e mohojnë kryerjen e veprave penale ngase kjo sipas vlerësimit të gjykatës është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe janë në kundërshtim me provat të cilave gjykata ju ka falur besimin, siç është deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit D.Sh., i cili ka dëshmuar se ka qenë më kolegun A.T., në detyrë zyrtare dhe ka qenë duke i shqiptuar një gjobë dëshmitarit B.Q., pasi që i njëjti kishte parkuar automjetin në mënyrë të parregullt dhe i kishte lutur që ta falin mirëpo nuk e kanë falur dhe i njëjti është pajtuar dhe i ka dhënë dokumentacionin që të ia shënojnë gjobën, ndërkohë iu është afuar i akuzuari N.. i cili i ka lutur që ta falin dëshmitarin B.Q., ku zyrtari policor D... e ka njoftuar se nuk bënë dhe i njëjti iu është drejtuar me fjalët se “keni qu krye, s’di qa po ju duket vetja, kështu edhe mua ma ke marr patentën po të njoh, ke qenë në shkollë me djalin tim, fale këtë person”, pastaj i dëmtuari iu është drejtuar se largohuni se nuk jeni palë dhe për të komunikuar duhet të vendosni maskën pasi që ka qenë koha e pandemisë dhe i njëjti ka vazhduar prapë me fyerje ku i dëmtuari ia ka kërkuar letërnjoftimin dhe i njëjti ka refuzuar pastaj për shkak të mos dhënies së letërnjoftimit e kanë njoftuar se është i arrestuar ku kanë tentuar të ia kapin duart që të ia vendosin prangat dhe i njëjti ka refuzuar, ndërsa i akuzuari B.. nga prapa e ka kapur për qafe e tërheq nga pas dhe është

rrëzuar së bashku me të, ndërsa i akuzuari Sh. në momentin sa kanë qenë të rrëzuar dhe po e mbante i akuzuari B...e godet disa herë me shkelm në fytyrë duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. Po ashtu Gjykata ia ka falur besimin deklaramit të dëmtuarit – dëshmitarit A...T... i cili ka treguar lidhur me shqiptimin e gjobës dhe momentin kur ka ardhur N... dhe sjelljet e tij njëjtë si i dëmtuari D...dhe në momentin kur e kanë njoftuar se është i arrestuar i njëjti ka refuzuar duke i tërheq duart dhe këta janë mundur ta arrestojnë, ndërkohë të dy të akuzuarit B... dhe Sh.. pa biseduar fare nga restoranti kanë vrapuar dhe B... e kap me një rëndë dorë nga prapa e ka kapur për qafe të dëmtuarin D... duke e shtrënguar dhe e ka tërhequr prapa ku të dy janë rrëzuar duke e mbajtur për qafe duke mos e lëshuar dhe për derisa kanë qenë të rrëzuar i akuzuari Sh. e ka goditur me shkelm në fytyrë disa herë duke ia shkaktuar lëndime në fytyrë. Po ashtu nga provat materiale siç është video incizimi i vendit të ngjarjes vërtetohet e njëjta gjendje faktike pasi që shihet se dëshmitari B.Q., shihet duke biseduar në telefon pas automjetit të tij, pastaj pas automjetit nga ana e video incizimit shihet duke biseduar i akuzuari N.. me zyrtarët policor (nga ky këndë nuk shihen veprimet dhe biseda e zhvilluar në mes të N... dhe zyrtarëve policor), mirëpo tutje shihet se dëshmitari B.Q., pastaj ishte afër tyre rreth një metër përball tyre, ku shihen zyrtarët policor duke vepruar ku ky nga prapa e prek me dorë pra ka qenë afër, po ashtu në hyrje të tarasës së lokalit shihet po ashtu dëshmitari B.B., i cili largohet nga vendi i ngjarjes ndërsa punëtori – kamerieri gjatë gjithë kohët qëndron aty përballë vendit ku ishte duke u zhvilluar biseda. Kur është tentuar për me arrestuar të akuzuarin N..shihen të akuzuarit Sh... dhe B... duke vrapuar dhe pa biseduar fare sulmojnë zyrtarët policor ku B... nga prapa e kap për qafe duke e shtrënguar të dëmtuarin D... duke e tërhequr nga pjesa e përparme e automjetit të dëshmitarit B... shtyhen afërisht tri metra tek hyrja e terasës ku rrëzohen pasi që B... e tërheq nga prapa, ku i akuzuari B....e kap për qafe dhe nuk e lëshon, ndërsa i akuzuari Sh... e godet me shkelm në fytyrë të dëmtuarin D... i cili ishte i rrëzuar në tokë më të akuzuarin B..., pastaj i dëmtuari A... i shkon në ndihmë për ta tërhequr të akuzuarin Sh. ku i njëjti e rrëzon të dëmtuarin A... të cilin e godet duke qëndruar mbi të, ku i dëmtuari A.... lirohet duke u përleshur ku i dëmtuari A. e nxjerr sprejin dhe ia lëshon të akuzuarit B... dhe shkon për ta ndihmuar kolegun D... i cili ishte në tokë, ndërsa i akuzuari Sh... fillimisht bisedon diçka me N..., pastaj shkon tek i dëmtuari D... dhe e shkelmon prapë me shkelm në fytyrë të cilin ishin afër rreth dy metra, pastaj prapë i godet të dëmtuarit të cilit ishin në tokë dhe pastaj vijnë përforsimet policore ku prapë njëri nga të akuzuarve bën rezistencë ku i njëjti neutralizohet tek automjeti i dëshmitarit B.. dhe arrestohet, ndërsa i akuzuari tjetër reziston brenda terasës derisa edhe ai arrestohet. Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit B.Q., i cili ka deklaruar se jam njoftuar se do të më shqiptojnë tiketë dhe i ka lutur që të më falin mirëpo nuk më kanë falur jam pajtuar dhe iu kam dhënë dokumentet pastaj ka ardhur N... dhe i ka lutur që të më falin, mirëpo nuk më kanë falur pastaj i kam thënë N... se nuk ka lidhje dhe pastaj kam qenë në telefon, i njëjti në shqyrtimin e parë kishte dëshmuar se të gjithë kanë qenë në tokë duke u përleshur por veprimet nuk ka qenë konkret në veprimet e të akuzuarve dhe të dëmtuarve po ashtu në rigjykim ka deklaruar një fakt të cilin nuk e kishte deklaruar më parë se kinse i dëmtuari D... i kishte thënë N...se të arrestoj dhe të ngrehi zhag për të cilin fakt gjykata nuk ia fali besimin, për çka edhe dëshmia e tij nuk ka relevancë lidhur me veprimet e të akuzuarve B... dhe Sh...Po ashtu dëshmitari B.B., ka dëshmuar se edhe mua më kanë shqiptuar tiketë dhe sjelljet e zyrtarit policor D... nuk kanë qenë në rregull, pastaj i kamë parë duke biseduar me N... i cili i ka lutur që ta falin dëshmitarin B...ndërsa tutje ka dëshmuar se kam parë që situata ka qenë e tensionuar dhe jam larguar duke i thënë bashkëshortes se merre veturën dhe ik nga këtu pastaj vetëm kur i kam parë në tokë duke sqaruar se të pandehurit Besnik dhe Sh. kanë qenë në lokal duke pirë kafe, kanë qenë të ulur jashtë larg vendit ku ka ndodhur rasti 10 deri 15 metra dhe këta kur e kanë parë që ka donë me e arrestuar vëllain e vetë janë ofruar, pastaj unë duke i tërheq punëtorët e mi për me u largua kur jam kthyer i kam parë të gjithë të rrezuar në tokë. D... është rrëzuar në tokë mbi D... nuk e di a ka qenë N... apo B.... D.... ka qenë i lënduar, ka pas gjak në fytyrë, ka pasur edhe gjak në tokë dhe pas përfundimit të hetimeve

e kam pastruar, njollat prej gjakut që kanë qenë në tokë kanë qenë të dëmtuarit D...Gjykata deklarimit të dëshmitarit ia fali besimin pjesërisht lidhur me disa fakte të cilat nuk janë kontestuese, mirëpo i njëjti në dëshminë e tij nuk ka qenë i qartë lidhur me veprimet e të akuzuarve dhe të dëmtuarve lidhur me përleshjen fizike duke e treguar në përgjithësi duke mos dhënë sqarime detale se si ka rrjedh përleshja. Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe nga vet deklarimi i të akuzuarit B... i cili e pohon faktin se të dëmtuarin D... nga prapa e ka kapur për qafe dhe e ka tërhequr prapa duke u rrëzuar së bashku me të, po ashtu ka pohuar faktin se nuk e kam goditur të dëmtuarin D... por vetëm e kam mbajtur për qafe, ndërsa lëndimet ndoshta i janë shkaktuar kur është rrëzuar, këtë fakt e pohon edhe i dëmtuari se nuk e ka goditur por lëndimet ne gjunjë dhe në bërryl i janë shkaktuar kur është rrëzuar kur është tërhequr nga prapa por i dëmtuari dëshmon se lëndimet e hundës ia ka shkaktuar i akuzuari Sh... duke e goditur me shkelm për derisa ka qenë i rrëzuar dhe i mbajtur për qafe nga i akuzuari B..., këtë e ka dëshmuar edhe i dëmtuari – dëshmitari A..., po ashtu kjo ka edhe logjikën se përderisa tërë kohën e ka mbajtur me dorë për qafe (gati në ngulfatje) nuk ka logjikë që i njëjti të ketë mundur të bie me fytyrë në tokë sipas pretendimeve të mbrojtës pasi që i akuzuari ishte duke e mbajtur për qafe nën të dëmtuarin në toke duke mos e lëshuar, po ashtu Gjykata nga deklaratat e dëshmitarëve B.Q., dhe B.B., ka vërtetuar se të gjithë si të akuzuarit dhe të dëmtuarit kanë qenë të përfshirë në përleshje pasi që të dy dëshmitarët kanë deklaruar se i kemi parë në tokë, po ashtu që të dy kanë deklaruar se i dëmtuari D.. ka qenë i gjakosur. Po ashtu Gjykata nuk ia ka falur besimin deklarimit të akuzuarit Sh... i cili mohon faktin se e ka goditur të dëmtuarin D..., por e pranon se e ka goditur të dëmtuarin A... dhe se nuk ka qenë afër të dëmtuarit D..., mirëpo të kundërtën e kanë dëshmuar që të dy të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve si dhe nga video incizimi ku janë vërtetuar në tërësi veprimet e të akuzuarit Sh. ku gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, të dëmtuarin D... e ka goditur me shkelm në fytyrë duke ia shkaktuar lëndimet e rënda trupore.

Mbrojtja në rigjykim ka pretenduar se tek i dëmtuari D.Sh., nuk kemi të bëjmë me dënim – lëndim të rëndë trupor por gjykata ia ka falur besimin mendimit të përpiluar nga eksperti mjeko ligjore Dr.F.B., dhe procedimit të tij në rigjykim ka deklaruar se tek i dëmtuari D... Sh. janë konstatuar thyerje të kockave të hundës, plagë shquese në hundë, ndrydhje të indeve të buta të qafës parakrahut të djathtë të dy gjunjëve dhe është kryer ndërhyrje kirurgjike për reponimin apo kthyerjen në vend të kockës së thyer të hundës, këto dëmtime kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, këto dëmtime shoqërohen me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Ndërkaq tek i dëmtuari tjetër A.T., janë konstatuar ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të majtë dhe bërrylit të dorës së djathtë gjithashtu të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë por si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, gjithashtu me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. I dëmtuari D.SH., ka pësuar thyerje të kockës së hundës dhe kjo thyerje e kockës së hundës detyrimisht duhet të reponohet me intervenim kirurgjik, pra pjesët e kockës së thyer duhet të kthehen në vendin e vet, në qoftë se nuk kryhet një intervenim i tillë pasojat nga ky dëmtim mund të jenë të përhershme. Aty është qëllimi i ndërhyrjes kirurgjike që fragmentet kockore të thyera të kthehen në pozitë anatomike-natyrale se përndryshe thashë edhe më përpara pasojat nga kjo thyerje ngelen të përhershme. Nuk ka nevojë nga jashtë pasi që ata i kanë metodat për intervenime. Po ashtu Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes ku shihen njollat e gjakut të dëmtuarit D.SH., si dhe nga foto lëndimet tek të dëmtuarit. Mbrojtja e ka kontestuar ekspertizën e ekspertit mjeko ligjore duke pretenduar se nuk ka pasur thyerje dhe nuk ka pasur intervenim dhe gjykata për të vërtetuar këtë ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit Dr.I.E., i cili ka deklaruar sipas dokumentacionit pacienti ka qenë i shtruar për 5 ditë në repartin e ORL-së, është pranuar pas një aksidenti rrahje me frakturë të ashtit të hundës dhe një plagë në lëkur jashtë nga hunda, nga mjekët tjerë të cilët janë konsultuar në emergjencë me siguri janë të shënuara edhe ndrydhje në qafë, në parakrahun e djathtë në të dy gjunjët dhe gërvishtje në gjurin

e djathtë, ky rast në ORL-së është reponuar fraktura që d.m.th. hunda ka dal në vendin e vet, pasi që ka qenë një thyerje dhe plaga është qep, ku pas 5 ditëve pacienti ka dal nga spitali në gjendje të mirë, kurse fiksimi nga jashtë me fllastera i ka mbajtur edhe 5 ditë tjera, kjo ka qenë gjendja e pacientit. Sa i përket lëndimeve çdo thyerje kategorizohet në lëndime të rënda por që mund të jetë me pasoja apo pa pasoja për jetën, në rastin konkret sipas dokumentacionit lëndimi ka qenë i rëndë, thyerje ka pasur, operacionet çdo intervenim që bëhet në pacient quhet operacion, në këtë rast tek ky pacient është bërë reponim - operacioni me duar dhe instrumente dhe është pozicionuar hunda në vend, ka pasur ndërhyrje – operacion. Intervenimi është bërë me duar dhe me instrumente ku kockat e vogla janë qit në vendet e veta të cilat kocka kanë qenë të thyera. Fraktura e ashtit të hundës, pra Gjykata ka vërtetuar faktin se dëshmitari në cilësi të mjekut ka intervenuar tek i dëmtuari duke e trajtuar me operim për çka gjykata ia ka falur besimin, po ashtu është kontestuar se në rastin konkret nuk ka pasur rëngën për të dëmtuarin ku gjykata në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar Dr.B.J., – Radiolog i cili ka vërtetuar se nga raporti të cilin e kam përpiluar sipas përshkrimit që e kam bërë është vetëm një frakturë e kockës së hundës, nuk kam përmendur shenja për dislokim të frakturës dhe pa ndryshime tjera evidente, bazuar në këtë raport që e kam lëshuar. Dhe unë raportin e kam lëshuar duke u bazuar në një rëngën-fotografim. Pa rëngën unë nuk kisha mundur me e bërë këtë konstatim, pra donë të thotë se e kam parë rëntgenin. Edhe në raportin tim edhe në raportin e mjekut të ORL-është e përshkruar si frakturë e kockës së hundës, nuk është e precizuar, për çka Gjykata ka vërtetuar edhe besueshmërinë e Dr.I.E., si dhe ka vërtetuar faktin se në rastin konkret ka pasur rëngën dhe po ashtu në bazë fletë lëshimit ku është shënuar edhe nga radiologu – eksperti i radiologjisë Dr.B.J., që ka pasur frakturë të hundës pra ka qenë e konfirmuar fraktura e hundës, prandaj të gjitha këto dëshmi e sidomos akt ekspertimi i ekspertit mjeko ligjore Dr.F.B., është vërtetuar se tek i dëmtuari D.SH., lidhur me dëmtimet kemi të bëjmë me lëndim të rëndë trupor.

Gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit B... dhe Sh.H., me dashje kanë kryer veprën penale dhe në bashkëkryerje pasi që i akuzuari B.. pa biseduar nga prapa e kap për qafe të dëmtuarin D., duke e shtrënguar për qafe dhe duke e tërhequr nga para duke u rrëzuar së bashku me të dhe duke e mbajtur për qafe në mënyrë që mos të mund të mbrohet, ndërsa i akuzuari Sh. e godet me shkelm të këmbës në fytyrë duke ia shkaktuar lëndimin e rëndë trupor, për çka veprimet e tyre e bëjnë veprën penale në bashkëkryerje, ku mund të konstatohet se formohet elementet e veprës penale se të njëjtit me dashje kanë kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që secili prej tyre kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale njëri duke e mbajtur duke mos e lejuar që të mbrohet ndërsa tjetri duke e goditur për çka është formuar bashkëkryerja.

Lidhur me gjenden faktike në pikën II të këtij aktgjykimi, që ka të bëjë me veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së, Gjykata do të vlerësoj fillimisht pjesën dënuese që ka të bëjë më të akuzuarin SH.H., ku i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i ka pranuar veprimet se të dëmtuarit A,T,m ia ka shkaktuar lëndimet trupore duke i kërkuar edhe falje, po ashtu kjo vërtetohet edhe nga deklarimi i të dëmtuarit A.T., i cili ka dëshmuar faktin se si është mundur ta tërheq të akuzuarin Sh. pasi që i njëjti ishte duke e goditur të dëmtuarin D..., ku pastaj i njëjti e godet dhe e sulmon ku veprimet e tilla shihen edhe në bazë të video incizimit të vendin të ngjarjes, po ashtu këtë e pohon edhe vet i akuzuari, ndërsa lidhur me lëndimet e shkaktuar të dëmtuarit A.T., janë vërtetuar nga akt ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor Dr.F.B., të sqaruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili ka konstatuar se tek i dëmtuari A.T., kemi të bëjmë me ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të majtë dhe bërrylit të dorës së djathtë gjithashtu të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë por si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, gjithashtu me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Pra nga mbrojtja nuk janë kontestuar veprimet dhe në një formë i

akuzuari ka pranuar veprimet e tij ndaj të dëmtuarit A.T., për çka Gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ka të bëjë me të akuzuarin N.H., i cili është akuzuar se në bashkëkryerje me të akuzuarin Sh.H., ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së. Gjykata fillimisht ka vlerësuar veprimet e të akuzuarit i cili kishte dal nga lokali dhe i kishte lut zyrtarët policor që të falin dëshmitarin B.Q dhe pastaj kur është njoftuar se nuk do të falin i njëjti ka filluar me fjalë si keni “qu krye kush po ju doket vetja edhe mua ma keni marr patentën”, pastaj i dëmtuari D... iu është drejtuar se largohu se nuk je palë dhe se duhet ta vendos maskën për shkak të pandemisë i njëjti prapë këmbë ngul dhe zyrtarët policor ia kërkojnë letërnjoftimin dhe i njëjti refuzon ku zyrtarët e lajmërojnë se do të arrestohet dhe i njëjti reziston te kjo gjendje faktike e vërtetuar tek veprimet e të akuzuarit nuk kemi vepër penale pasi që fjalët e përdorura nuk kanë qenë kërcënuese dhe se veprimet e tij nuk kanë qenë përdorim i forcës dhe për këtë arsye nuk përmbushen elementet e veprës penale pengim apo sulm ndaj personit zyrtar, fakti që ka refuzuar të iu jap letërnjoftimin dhe kundërshtimi i prangosjen kemi të bëjmë me vepër kundërvajtës që ka të bëjë me dispozitën kundërvajtës mos zbatim i urdhrave e cila sanksionohet sipas ligjit për kundërvajete, pra nuk përmbushen elementet e veprës penale, pasi që nuk kemi kanosje apo përdorim të forcës. Po ashtu tek veprimet e tjera ku të akuzuarit tjerë kyçen dhe ndodh përlëshja i akuzuari N.H.,sipas dëshmisë së vet të dëmtuarit A. i cili ka deklaruar se i akuzuari nuk më ka sulmuar apo goditur, po ashtu edhe në rigjykim ka deklaruar se nuk jam i sigurt se a më ka shtyrë, po ashtu dëshmitarët B.Q, dhe B.B., nuk kanë dëshmuar që i akuzuari N... të këtë goditur apo shtyrë të dëmtuarin A.T, e po ashtu edhe të akuzuarit tjerë nuk kanë deklaruar se N... e ka goditur apo sulmuar të dëmtuarin A.T., epo ashtu nga i dëmtuari D... i cili ka deklaruar se nuk i kam parë veprimet e N... në drejtim të A.t, po ashtu nga video incizimi i vendit të ngjarjes nuk shihet se i akuzuari N.H., të këtë sulmuar të dëmtuarin A.T., apo ta këtë shtyrë, për çka Gjykata në bazë të një deklarami të tillë të dëmtuarit A. i cili nuk është i sigurt se i akuzuari Ne... e ka shtyre apo ta këtë penguar me ndonjë veprim një pasiguri e tillë në deklaramin e tij, Gjykata ka vendosur ne favor të akuzuarit pasi që vetëm me një deklaram të tillë nuk mund ta shpall fajtor duke mos u përmbushur elemente e veprës penale për të cilën akuzohet, për çka Gjykata ka marr aktgjykim lirues në mungesë të provave në kuptim të nenit 363 parg.1 nën parg. 1.3 të KPP-së.

Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari N.H., ka kryer veprën penale në bashkëkryerje me të akuzuarin Sh.H., me të cilën ngarkohet dhe vendosi që njëjtin ta liroj nga akuza, duke marr parasysh faktin se gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes ka obligim ligjor që të provojë të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pakontestueshme, pra faktet që shkojnë në favor të akuzuarit e në veçanti lidhur me nenin 3 të KPP-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj, po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë, kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

##### 5. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se të akuzuarit B... dhe ShH., me dashje kanë kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Po ashtu i akuzuari SHH., me dashje ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi. Ndërsa për të akuzuarin N.H., lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka marr aktgjykim lirues.

#### 6. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarve

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata i ka shpall fajtor të akuzuarit Sh... dhe B... H., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.6 lidhur me par. 2 dhe parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, po ashtu të akuzuarit Sh.H., me dashje ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 402 par.4 lidhur me par. 2 dhe parag.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

#### 7. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit B.H., jeton vet i 7 në familje, i pa punë, bujk, merr pension për veteran të luftës, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte qytetar i rëndomtë dhe se asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes nga i akuzuari për të kryer veprën penale i njëjti i sulmon zyrtarët policor. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin kur ka shqiptuar dënimin me burgim të përcaktuar me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për të akuzuarin, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit SH.H.,: jeton vet i 7 në familje, punon në botën e jashtme Austri, i martuar, i moshën e tij relativisht të re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte qytetar i rëndomtë dhe se asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale si dhe pranimin e veprimeve lidhur me shkaktimin e lëndimeve të dëmtuarit A.H., kërkim faljen për rastin e ndodhur. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes nga i akuzuari për të kryer veprën penale i njëjti i sulmon dy zyrtarët policor. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të

akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin kur ka shqiptuar dënimin me burgim e përcaktuar me ligj si në dispozitiv të aktgjykimit për të akuzuarin, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.3 të KPP-së.

#### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Për të akuzuarit B...dhe SH.H., vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për të akuzuarin N.H., në bazë të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në mjetet buxhetore të gjykatës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 par.1 dhe nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i Krimeve të Rënda -**  
**PKR.nr.90/21, me datë 09.07.2024**

**Zyrtarja Ligjore,**  
**Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor**  
**Gjykatësi**  
**Drilon Haraçia**

**KËSHILLA JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.